
DRITA SHALA - ÇUNAKU
KOLONA E UDHËS SË DJEGUR
ME TRI GJENERATATE
BISLIM BAJGORES

DRITA SHALA - ÇUNAKU
KOLONA E UDHËS SË DJEGUR
PROZË SHQIPTARE
Redaktor
TAFIL DURAKU
Recensues
ILAZ PROKSHI
'Kushtuar birit tim Artit, I cili më dha force të tejkaloj sfidën e luftës në Kosovë gjatë vitit 1999, përjetuar në kolonat për deportimin e popullatës Shqiptare"
-Autorja

DRITA SHALA - ÇUNAKU

KOLONA E UDHËS SË DJEGUR

PROZË SHQIPTARE

Redaktor

TAFIL DURAKU

Recensues

ILAZ PROKSHI

Ilustrimi

KUJTIM SH DEMIRI

''Kushtuar birit tim Artit, I cili më dha forcë të tejkaloj sfidën e luftës në Kosovë gjatë vitit 1999, përjetuar në kolonat për deportimin e popullatës Shqiptare''

O bilbil Kosova, hije të paska shkolla

Ti moj kosovare, sot ti je krenare

Ju-bubu tranajne, ju-bubu trajnane...

…Këngë që thyente ritmet e hapave të rreth 2,500 njerëzve në kolonën e heshtur, e cila si nëpër ëndërr të mjegulluar marshonte, pa destinacion, nëpër udhën e djegur të trojeve të drenicës; të djegur e të shkrumbuar nga famëkeqët lakmitarë e luftëdashës…

Të njejtën këngë e kisha kënduar edhe më parë, si këngë gëzimi. Gëzim për shtëpinë në të cilën Arti i vogël arriti nga spitali i qytetit te minatorëve, qytetit të Mitrovicës, ku ishte lindur dhe kishte kaluar 12 ditët e para të jetës së tij. Edhe pse ndihesha mjaft e lodhur, mundohesha që Artit të vogël, që nga fillimi i jetës së tij, aq sa kisha mundësi,

t'ia plotësoja jetën me harmoni, duke i kënduar dhe duke folur me të ne të gjitha mënyrat e mundshme. Mundohesha t'ia largoja brengat duke zbutur dhe zbukuruar çdo fjalë që flitej rreth tij.

Bëhesha se nuk po dëgjoj fare Dr. Sanijën, tezën e Artit, që shumë e merakosur fliste për humbjen e peshës se tij gjatë qëndrimit në spital. Menjeherë pas lindjes peshonte 4.2 kg, kurse tani, pas 12 ditësh qëndrimi, kishte rënë nën 3 kg. Edhe pse zvogelimi i peshës ishte normale në javën e parë, kjo ulje ishte brengosëse.

Nuk ia veja veshin as Beharit, babit të Artit, kur me pyeste pse nuk i kisha ruajtur çelsat automatik për hapjen e ushqimeve qe m'i kishte dërguar gjatë qëndrimit tim në spital.

As tezja e Artit e as babai i tij nuk e dinin se, edhe pse këndoja dhe e përgëzoja Artin me

fjalë hareje, nëpër mendjen time silleshin vërdallë ditët kur isha e shtrirë në spital, qëndrim ky që zgjati më tepër se zakonisht pasi që lindja ishte kryer me prerje cezare. Njëkohësisht edhe rreziku për Artin qe shumë i madh. A thua a mund t'i shpjegoj shikimet e shumicës nga personeli i punësuar në ato reparte mjekësore, ku pjesa derrmuese ishte e mbushur me nëna dhe foshnje shqiptare, ndërsa mbi 90% e të punësuarve ishin të nacionalitetit sërb. Sjelljet e tyre aspak nuk përputheshin me obligimet dhe përgjegjesitë që duhej t'u përmbaheshin në ato vende pune. Me zili shikonin çdo paciente shqiptare. Njeherë, e pyeta një mamĩ për shëndetin e fëmiut tim, e ajo reagoi aq vrullshëm, si ta kishte pickuar dikush, e me britmën e saj jo vetëm që më trembi mua, po edhe pacientet tjera që gjindeshin në atë dhomë, duke më thënë se nuk kisha nevojë të pyesja për punët e tyre, e aq më pak të merakosesha për foshnjën time,

pasi që ai po e thithëka qumështin, bile edhe më tepër sesa duhej, sikur ujk. U mundova sa më butësisht t'a ikë shikimin, meqë e dija që Arti ishte i rrethuar nga ato qenie të çuditshme, që kishin përfshirë tërë repartin. A thua pse dinin të silleshin aq mirë me gratë serbe, kurse me foshnjat e tyre sikur t'i kishin lindur vet? A thua pse ato ditë vdiqën 5 foshnje shqiptare për një ditë?! Për një repart gjinekologjik ky numër ishte shumë i madh. Kjo gjë nuk kishte ndodhur kurrë, edhe kur kushtet kishin qenë shumë më të vështira sesa tani. Pesë foshnje që mezi ishin pritur nga prindërit e tyre. Njëra prej tyre, lindje e parë, e pritur pas shume vitesh martese, tjetra pritej të lindë djalë pas shumë vajzave...

E shtrirë në dhomën intenzive, për të vetmen gjë që mendoja ishte se si të dilnim nga këtu të gjallë unë dhe foshnja ime.

… E tani, në shtëpi, kur dëgjoja fjalë me një temë krejt ndryshe rreth meje dhe

foshnjës, nuk mund të besoja që disa njerëz me përvojë të madhe në këtë drejtim, të mos e kuptonin rrezikun e ekzistuar, në këtë rast, për mua e më shumë për Artin e posalindur. Më dukej e tepërt të flisja për një temë të tillë, pasi që gjëra të ngjashme vëreheshin në çdo mjedis. Vazhdoja me mendime, kurse me zë të lartë përgëzoja Artin e vogël me ninulla dhe vjersha të ndryshme, shumicën e të cilave i dija më parë, por shumica me vinin vetvetiu.

Hajde, hajde, avash, avash djali i mirë na erdhi tash; Djali i mirë, djali i mbarë, është ky Arti faqebardhë...

Këngët për Artin e vogël vazhdonin… Thurja ninulla me të madhe, për të cilën gjë merrja kritika të mëdha. Më kritikonin pse nuk i kishin dëgjuar më parë për fëmijet tjerë, nipat dhe mbesat, e përnjëherë, tani po i dëgjojnë me një përmbajtje të gjerë. Unë vetëm buzëqeshja dhe mendoja, pa ditur me e shprehë mendimin tim me fjalë. Edhe po

të dija, këto mendime, ma merr mendja, i dinte çdokush rreth meje, pasi që në masë më të madhe apo më të vogël, na perkisnin të gjithëve.

Vazhdoja të jem e buzëqeshur, duke u përpjekur që sa më tepër ta zbukuroj jetën për Artin e vogël, i cili kishte nevojë për gazmend. Që në muajtë e parë të jetës së tij, qartë po vërehet nevoja e tij për dëgjim, dëgjim të bisedave familjare e harmonike nga prindërit e tij; biseda që në çdo mënyrë po mundohem me ia plotësuar, nëse kjo është e mundur, sepse e dija se kjo gjë nuk varet vetëm nga unë. Por, në harmoninë familjare po reflektojnë rrethanat shoqërore, ku nuk po mund të ndikojmë…

Në sytë e të gjithëve isha nje grua mjaft e lumtur. lsha martuar me njeriun e ëndrrave te mia, i cili vetëm me shikim e dinte se çka doja të flisja. Që nga dita që ishim takuar në ndërtesën e fakultetit ekonomik,

kuptuam se ishim të krijuar për njeritjetrin. Të gjitha vështiresitë jetësore, i kalonim së bashku dhe me mirëkuptim, pasi që kishim vullnet të fortë për jetë të përbashkët. Të gjitha veprat jetësore i krijonim, dhe i krijojme për njëri-tjetrin. Kjo më mban në jetë. Ma ruan freskinë dhe çdo herë dukem e disponuar…

Por, si qëndron situata në të vërtetë? A është ende thelbi **i** dashurisë sime **i** shëndoshë? Mendoj se thelbi **i** lumturisë mund të jetë **i** shëndoshë, vetëm atëhetë, kur të jetosh pran njeriut të zgjedhur, njeriut te jetës. Njeriu nuk mund të ndjehet i qetë dhe i lumtur nëse nuk i ka kryer edhe obligimet bashkëshortore, në vatër familjare. Këtë, unë nuk kam mundur ta arrijë pasi që, si shumë të tjerë, bashkëshortin tim, herë pas here e përpinte fantazma e gurbetit, që kishte hyrë edhe në labirinthet më të fshehta të vendit tonë.

Deri tani dy herë e kisha percjellë për në rrugët e largëta të perëndimit. Dy pjesë të jetës time ishin

të zbrazëta, me dy thyerje vullneti për të jetuar.

Pjellë e kujt mund të jetë ky deformim total i lumturisë sime? Sikur të mos e largonin bashkëshortin tim nga puna, sigurisht nuk do t'i kisha përjetuar këto plagë kaq të rënda. E larguan. E largoi politika e ndyrë serbe. Edhe pse me njohuri dhe aftësi superiore, e larguan vetëm pse ishte shqiptar, për të punësuar në vend të tij shumë të tjerë, të mbledhur nga kafenetë apo nga rruga, e të ngjashme, vetëm pse ishin sërb, duke u mundësuar jetë luksoze dhe duke i armatosur deri në dhëmbë. Kështu, njerëzit tanë, deshtën apo nuk deshtën, u detyruan ta marrin rrugën e zezë të gurbetit, për ta siguruar ndonjë para për ekzistencë, për t'i ushqyer familjet e veta me kafshatë, kafshatë gurbeti, kafshatë helmi, që të helmon

dalëngadalë dhe në këtë apo atë mënyrë, të zhdukë dhe të jepë një ego krejt tjetër, përkundër asaj që me gjenerata jemi munduar t'i ikim.

Në këtë gurbet bashkëshorti im fitonte pak para, duke u kthyer i molisur dhe i rraskapitur nga punët e rënda që mbeteshin për t'i kryer rinia shqiptare. Mua më sillte garderobë të mrekullueshme, të cilën të gjitha shoqet ma shikonin me lakmi. E veshja me krenari të madhe për t'i zbutur plagët tona jetësore. Në fakt, në thellësinë e zemrës sime, kjo veshje nuk vlente asgjë më shumë se një leckë e djersitur dhe e përgjakur që të vie të vjellësh prej saj. Në çdo moment nëpër mendje më sillej origjina e saj, origjinë gurbeti që ma ka thyer lumturinë time, e që po shpresoj se do të më kthehet tani me lindjen e Artit. Kam dëgjuar se pa marrë parasysh rrethanat, fëmija t'a kthen lumturinë, edhe përkundër sjelljeve, tani për mua mjaft të njohura,

nga burri im. Sjellje paralajmerimi për gurbet të zi.

O Zot! Prap gurbeti!

Më kujtohet vetja kur isha fëmijë, nëpër dasma, kur gratë flisnin për ndonjë nuse e cila kishte burrin në Gjermani a gjetiu. Pa marrë parasysh veshjen e saj luksoze dhe stolitë e shumta prej ari a diamanti, gjithmonë e shikoja me dhembje të madhe dhe më dukej se jeta e saj nuk vlente asgjë. Nuk me shkonte mendja se një ditë do ta përjetoj të njejtin fat.

2.

Erdhi dita e nisjes, edhe për herë të tretë, e bashkëshortit tim në mërgim, tani edhe babai i Artit që kishte mbushur 4 muaj e 11 ditë. Duhet ta përballoj edhe këtë herë. Kam menduar se me fëmiun, kjo ndarje do të jetë më e lehtë, por si duket, qenkam mashtruar. Tani mërzitesha dy

herë m tepër, mërzitesha për veten, e për fëmiun edhe më shumë. Më dukej se me shikimet e tij prej fëmije, shikime naive dhe të pafajshme, po e kërkon babain e tij; Po e kërkon dorën e tij që me aq ngrohtësi e mbante të mbështjellur, dhe me orë të tëra e shetiste, madje edhe nepër dhomë.

Arti qante dhimbshëm e tmerrshëm nga uria. Tri ditë nuk pata qurmësht gjiri, i cili m'u ndërpre nga pikëllimi. Çdo pasdite, në kohën kur kthehej babi i Artit, më dukej se e priste trokitjen e tij në derë, të cilën aq mirë e njihte dhe e dallonte, ku pernjëherë i ndërrohej disponimi, qeshte dhe kërcente. Tani pritnim vetëm cingërimat e telefonit, që ishin shumë më të rralla se sa dy herave të tjera. Edhe pse shumë shkurt, mezi ndërronim dy-tri fjalë, kjo bisedë nëpër telefon na freskonte dhe na jepte vullnet për të jetuar dhe për të pritur ndonjë ditë më të mirë, me shpresë se do t'u vinte fundi këtyre gurbeteve te mallkuara, që na e gëlltisnin, pa hetuar,

pjesën dërmuese të rinisë. Rinia jonë që po anon kah fundosja në shtetet perendimore, në të cilat nga çdo anë hasen lule mjaft të bukura, por pa erë; fëmijë të zbukuruar, por pa buzëqeshje; të rinjë me veshje e jetë luksoze, por pa rini. Nganjeherë, vetëm në gurbet gjindej rrugëdalja e mundshme.

Nuk më largohet sysh pasqyra e dajes Nijazi të Artit nëpër qytetin e Mitrovicës, i cili ishte bërë 20 vjeç, dhe në vend që t'u gëzohej vjetëve të veta, mundohej ta fshehte trupin e tij që të mos u binte ne sy policëve sërb, të cilët pa kurfar komenti rrëmbenin rininë, kinse për shërbim ushtarak e që në fakt rrallëkush nga shqiptarët ktheheshin shëndosh e mirë. Natyrisht, edhe daja Nijazi u detyrua të largohet nga vendi i tij.

Edhe ne gjendemi në Evropë. Pse të mos rrimë në vendin tonë? Kur do t'na lerë të qetë, e të mos na e rrembejë nga goja këtë kafshatë, edhe ashtu mjaft të thjeshtë, ky

mikrob qe infektoi tërë rajonin. A thua çfarë mikrobi është ky? Për zbulimin e tij po bënë përpjekje e tërë bota, e cila ende po mendon se mund të ndalet në mënyrë paqësore. Kështu po mendojmë edhe ne, e njëkohësisht në lëkurën tonë po e ndjejmë një torturë që dalëngadalë po na eliminon me mënyra speciale, disa duke i dëbuar, disa duke i rrëmbyer nga lulja e rinisë dhe duke i kalbur në burgje që shumica po vdesin para kohe nga pamundësia e qëndrueshmërisë së këtij represioni të armikut. Armik ky që po përdorë metoda të shumta për arritjen e qëllimit te vet, duke na e cunguar çdo të drejtë njerëzore, që nga e drejta për shkollim e deri te helmimet më brutale të fëmijëve nëpër shkolla. Njeriu shqiptar assesi nuk mund të ekzistojë dhe ta ushqejë familjen e vet në mënyrë te ndershme, keshtu që, deshti apo nuk deshti, herët apo vonë, ai duhet t'a marrë

rrugën e mërgimit, ose të vdes. Kjo gjë po vërehet qartë prej shumë kohësh.

Edhe më tej po mundohem që në çdo menyrë të qëndroj në truallin tim, për mosshkëputje nga Kosova, përkundër largimeve të shpeshta të bashkëshortit tim, të cilit në çdo mënyrë po mundohem t'ia forcojë karakterin, edhe ashtu të fortë, t'a përmbajë moralisht që të mos largohemi, si ai ashtu edhe unë, nga egoja jonë. Le ta dijë se nuk është i lindur për bredhje nëpër rrugë të huaja, përkundër gjendjes së jashtëzakonshme; le t'a dijë se është shqiptar i lidhur për vendi të vet, njeri që i duhet Kosovës dhe më shumë Kosova i duhet atij, të mos pajtohemi me nënçmimet nga popujt tjerë. Vetëm në Kosovë ekziston mundësia të mos jemi te nënçmuar. Plot familje, me plot arësye po marrin këtë rrugë trishtuese, të gjithë me shpresë për tu kthyer përsëri. Unë kthimin nuk e paramendoja të lehtë…

Nuk mund të imagjinoja të mbetem përherë në vend të huaj…

Duhet të qëndrojmë përkundër rreziqeve egzistuese, të cilat shumë më pak i kam paraparë. Dy herë me parë babai i Artit, Behari, kishte punuar nëpër punëtori të Evropës perendimore. Të parën herë 4 muaj, ndërsa të dytën 8 muaj e gjysmë. Tani ishte hera e tretë që largohej. Gjatë kësaj kohe, që ishte më e gjatë, i mangët ka qenë gëzimi im për dhëmbin e parë të Artit, për fjalën e tij të parë, për ditëlindjen e parë.... Por, durim! Më mbante ne jetë pritja e shokut tim te jetës, momenti i kthimit te tij. Sa e sa gjëra kisha ndër mend t'ia shpjegojë. Shumë dilema i kisha lënë për t'i zgjedhur së bashku me të. E di, mendoj se e njoh, më pelqejnë zgjedhjet e tij të çdo problemi, që e pranonte me plot mirëkuptim. Çdo ditë i jepja vetes kurajo, duke arsyetuar mallin për te, për faktin se jam duke pritur njeriun e zgjedhur te jetës time, njeriun që e çmoj

shumë... Ne gratë shqiptare kemi traditë për të pritur. Mendoj se asnjë grua nuk di me e pritë burrin sikur ne. Një mënyrë e tillë jetese, me shekuj i ka percjellë femrat shqiptare, si pjellë e robërimit të tokës tonë nga barbarë te lloj-llojshëm. Ky fat, deridiku, më përcolli edhe mua. Edhe unë qëndroj, dhe për çdo ditë e pres burrin sikur toka e plasaritur nga thatësira që pret pikat e shiut. Çdo çast pritja lajmin kur do të kthehet. U bënë gjashtë muaj, u bë një vit, një vit e gjysmë, gati dy vite. Edhe kjo ditë do te vie. Dhe me të vërtetë erdhi.

Arti pat mbushur dy vjet. Babai i tij lajmëroi se është nisur. Në mua u ballafaquan përnjeherë gëzimi dhe frika. Lufta e përgjakur shpërtheu në Drenicë, duke vazhduar me masakrat në familjën e Jasharëve në Prekaz, që gjithnjë zgjerohej. Edhe ajri në Kosovë gjendej nën presion luftarak. Lajme të tmerrshme nga çdo anë. Vrasje të shqiptarëve të pafajshëm nga forcat okupuese sërbe, me

metoda shtazarake, që mendja e shëndoshë nuk mund t'i paramendojë. Babai i Artit nuk ndalej, depërtonte mes plumbave dhe nuk e shkelte vendimin e tij për kthim tek gruaja, djali, nëna, vëllezërit, motrat dhe toka shqiptare, e cila nuk na le dot të shkëputemi prej saj. Nga mesi i marsit 1998 arriti edhe momenti i kthimit nga mërgimi. Hera e tretë ·e kthimit te tij. Përkundër rrethanave mjaft serioze, seriozitetit luftarak, për mua, në moment m'u duk se shkrepi një rreze e re dielli. M'u duk se i tërë mundimi dhe vuajtjet në moment m'u shpërblyen. Ndoshta do të marrë fund njeherë e përgjithmonë ky udhëtim gurbetçar dhe do t'i gëzojmë, sadopak, kënaqësitë familjare, duke e ndarë të mirën e të keqen së bashku. Do t'a vazhdojmë jetën ashtu siç e kishim nisë.

Vallë, a është e mundur kjo gjë?!

Vallë, a ka lënë gurbeti ndonjë gërvishtje që vështirë mund t'i largohen gjurmët?

Shpesh kam dëgjuar për gjurmë të llojllojshme të mërgimit, por burri im gjithmonë ka qenë diçka krejt tjetër. Së paku kështu mendoja. Gjithmonë kam menduar se nuk mund ta zënë grackat e gurbetit. A thua jam mashtruar? Nuk e di, por duke u bazuar në disa sjellje te tij, pas një qëndrimi të tij më të gjatë larg atdheut, u binda se gurbeti askend nuk po e kurseka.

A është e mundur që Behari, si njeri stabil t'i ketë këto sjellje, shpesh të pakuptimta, të pavendosura, të humbura, të cilat sa e sa herë i ka gjykuar vet! Nuk e di. Vetëm e di se gurbeti qenka gjë e tmerrshme për të cilën kemi dëgjuar aq shumë, që nga fëmijëria e hershme. Përjetimi i tij, po nxitë që të kuptohet më rrënjesishtë. Njeriu gurbetçar, edhe njohuritë e lindura më nuk i ka të sigurta.

Do të luftojmë! Në këto luhatje të karakterit ngadhënjen armiku. Nuk duhet të dorëzohemi. Nëse dorëzohemi atëherë kemi humbur betejën. Këto imtësira do t'i korrigjojë toka jonë, që është pjesë e qenjës tonë.

3.

Të vendosur e të drejtuar kah qëllimi i dëshiruar, do të çlirohemi nga këto të liga që po na përcjellin gjatë, shumë gjatë. Të gjitha gjërat do të gjejnë vendin e vet që të vazhdojmë një jetë normale.

A thua si t'a arrijmë atë që po e ëndërrojmë dhe që e meritojmë. Duhet të nisemi nga themeli. Themeli i tëra vuajtjeve është robërimi nga okupatori. Duhet të çlirohemi nga ky robërim, pa marrë parasysh çmimin. Më mirë është

të vdesim se sa te vazhdojmë të jetojmë në këtë mënyrë. Edhe pse pa armë të mjaftueshme kundër një force gjakpirëse; me armatim larg të pabarabartë, vendosmerisht besojmë në një fitore që na takon; në një paqe ku do të bëjmë gjumë të qetë, ndërsa Arti i vogël t'a ndjejë vetën të sigurtë edhe kur nuk gjendet pranë babait te tij, pranë të cilit do të ndjente rehati të madhe dhe të cilit i beson shumë. Sa qartë po vërehet etja e tij për harmoni familjare, të cilën nuk e pat në foshnjëri, ndërsa për fëmijërinë e tij nuk po pushoj së menduari ditën as natën. Si fëmijët e tërë botës, edhe Arti ka të drejtë të ketë fëmijeri të lumtur, fëmijeri që në Kosovë gërshetohet edhe me pjekuri. Çdo fëmijjë shqiptarë në Kosovë e di sa i heshtur duhet të jetë jashtë pragut të shtëpisë, madje edhe për të shqiptuar fjalën nanë, vetëm pse është fjalë shqipe. Menjëherë vërehen shikime

të ashpra që me shtrëngim shtazarak të nofullave mundohen të të copëtojnë
Kurrë nuk mund të kuptohet vlera e lirisë pa e përjetuar këtë okupim. Mungesa e asaj lirie të shtrydhë ngado që të kthehesh. Sa veshtirë qenka kur nëpër rrugët e qytetit, në të gjitha dyqanet e ndërtuara ne truallin shqiptar, të trashëguar me shekuj e mileniume, të vehen reklamat në gjuhën dhe me shkronjat provokative të okupatorit. Nga ato reklama të duket se po rrjedhë djerse rrëke, nga qarkullimet e inspectorëve sërb, që për ç do ditë vizatohen në pragjet e tyre per t'i plaçkitur njerëzit që me mundime të mëdha mundohen të sigurojnë kafshatë goje për familjet e tyre, duke u orientuar në tregti, pak a shumë e lejuar nga pushtuesit. Fort mirë e dinin ata pse i orientonin njerëzit në këtë lami. Njerëzit tanë, me mendje të turbulluar, nga frika për egzistencë, si të tërbuar, me të gjitha forcat luftojnë mes vete si konkurrentë tregtarë. A shohin ata

anash, se si okupuesit me krenari ngadhënjimi shikojnë këtë vrap të çmendur konkurrues për fitim. Njerëzit me kapacitet të madh njohurishë nga lëmenj të ndryshëm, largoheshin me dhunë nga vendet e tyre te punës dhe orientoheshin, ku tjetër veç në tregëti, per t'u eksploatuar me lehtë, kurse nga aspekti intelektual, moral dhe i karakterit, të varfërohen deri në zero. Ky orientim në një degë, siq është tregëtia, për shumicën ishte fushë e panjohur dhe pa kurrfarë përgatitje paraprake. Por, prapëseprapë, më në fund, me mënyra speciale detyroheshin të falimentojnë dhe të mos gjejnë rrugë tjetër për egzistencë, pos rrugës së gurbetit.

Dora e shoferëve të automjeteve është autom- atizuar për ndërrirn stacioni në radio posa në rrugë dukej personeli komunikacionit, që natyrishti tëri ishte nga nacionaliteti okupues – sërb. Në të kundërtën, me dëgjimin e këngëve

shqipe, për imtësira do të denoheshin me gjoba që vështirë paguheshin.
Të gjitha këtyre zullumeve disi u qendrohej, por masakrat e papara mbi fëmijë, pleq e gra u bënë të tepërta. A thua do të na vijë ndonjë ndihmë nga forcat e mëdha perendimore, të cilët, të hutuar nga ky terror i paparë dhe i padëgjuar në historinë e njerëzimit, ndoshta, një ndihmë do t'a ndalte këtë bacil që mund të infektojë rajonin e më gjerë. Sido që të jetë, po shpresojmë shumë. Shumë po shpresojmë në një ndihmë ushtarake, posaçërisht nga Amerika. Te gjithë, i madh e i vogël, me vite të tëra jemi duke pritur me vesh ne krah se çdo të bëhet. Kur do të vijë më ajo ditë kur do t'i vehet një stop kësaj gjendjeje. Tubim pas tubimi, mbledhje pas mbledhjeje, samit pas samiti, konferencë pas konference... Njerëzit me funk- sione te larta botërore po debatojnë lidhur me Kosovën, e në

Kosovë, per çdo minutë vritet nga një shqiptarë. Shpresa, shpresa, vuajtje, vuajtje, pritje, pritje... Vështirë, shumë veshtirë, e, sidomos, në meset me koncentrim më të madh te policisë sërbe, siq ishte rasti i bllokut banesor ku jetonte edhe Arti i vogël me prindërit dhe familjet e tjera shqiptare.

4.

Rrezik per jetë. Nuk rrihet më ketu. Kështu ishte deklarata e babit të Artit. Menjëherë mori Artin për t'a dërguar tek gjyshja e tij, tek nana ime, në lagjen Tavnik. Është kjo pjesë e banuar vetëm me shqiptarë. Babai i Artit shkoi tek nana e tij, në Obiliq, të shihte se si qëndronte situata atje. Unë, në organizatën punuese qëndrova deri në kohën e pauzës dhe, nga rreziku që më kanosej sikur të gjithë shqiptarëve, ndalova së shkuari në repartin ku punoja. Të nesermen, nga mediat

dëgjuam se është vendosë që organizata më e madhe ushtarake në botë, NATO, do të bombardojë forcat serbe. Vetëm një ditë me vonë, ditën e merkurë, më 24 mars 1999, rreth orës 20, degjuam shpërthimet e para të bombardimeve, me ç'rast ndriçuan shpresat tona për shpëtim.

Ndoshta për nja një javë, më së shumti, do të çlirohemi nga këto zullume. Askush nuk mund t'i

qëndroje më shumë një force siq është NATO-ja. Këto mendime haseshin tek çdo njeri. Mezi kalonim ditën, nga shtimi i vrullshem i maltretimeve dhe vrasjeve të shumta, që morën hov të paparë nga ata shpirtëra të gjorë për të pirë gjak shqiptari. Vrasje mizore të njerëzve të pafajshëm nëpër shtëpitë e tyre. Më kot shtohej intensiteti i bom- bardimeve nga NATO. Forcat paramilitare dhe militare serbe bënin kërdi mes shqiptarëve duarthatë. Në pjesën e qytetit ku kisha banuar, shqiptarët torturoheshin nga njerëz të

armatosur e me fytyra të mbuluara me maska, duke i rrahur e maltretuar dhe duke u dhënë ultimatum prej 10 minutave që t'i lëshojnë vatrat e tyre, përndryshe, do t'i presin kokat e mashkujve. Në çdo pyetje kishin pergjegjje te shkurtër dhe të rreptë.

- "U Albaniju! u Albaniju!" - Në Shqipëri, në
Shqipëri, - urdhëronin çmendurisht...

- Oh! U çlirova, bre! Oh! U çlirova, bre! Ooohh!!! U çlirova, bre! bërtiti Kujtimi, tezaku i Artit, duke hyrë në oborr të shtëpisë në Tavnik. Pas tij vellai i tij, Edini, nuk bëzante fare, por me një shikim të thellë e të humbur tërhiqte me vështirësi disa valixhe.

Prindërit e tyre, disi, më shumë mundoheshin të qëndrojnë te fortë, edhe pse nga fytyrat e tyre mund të shpjegohej një histori e tërë.

Edhe këtyre, pa dallim prej të tjerëve, u kishte ardhur rradha t'i debonin nga

banesa, fytyrat e maskuara, me kërcenime, fyerje e ultimatum të shkurtë për largim, përndryshe, kokat e tyre do të priten pa mëshirë. Si shumica, edhe kjo familje ia kishte mesye laxhes Tavnik.

Shumë e habitur iu drejtova Kujtimit, i cili nuk mund të qetësohej, duke përsëritur fjalë të njëjta dhe duke i valavitur duart në drejtime të ndryshme, ndërsa kokën e tundëte, thuase e ke kurdisur që të mos ndalet. Fytyra iu kishte zvogëluar dhe zverdhur e bërë sikur dyll.

- Kujtim, qetësohu! Pse u çlirove?! Fol më, se po më shkon në nerva - i thashë me një ton paksa qortues, e në anën tjetër muskujt m'u shtanguan nga ajo pamje trishtuese.

- Oooj, tezja Dritë..., filloi të më shpjegonte duke marrë frymë thellë dhe duke pauzuar në të folur me pauza bukur të gjata.

- Tezjaaa... Dritë! Sa mirë... Sa mirë që u largove më herët nga ajo pjesë! Ka dy javë ... DY JAVË! Dy jaaavë as perden nuk e kam prekë... Po vlojnë ... Po vlojnë paramilitarët... Çfarë maltretimesh! ... O zot! O zot! U çlirova...

E shikoja si me shaka e me buzë në gaz për ta qetësuar sadopak, kurse në tapën e kresë ndjeja rrënjët e flokëve që më lëviznin nga rrënqethjet e tmerrshme që shkaktoheshin nga rrëfimet e fëmiut që ishte mbyllur në shtëpi për t'iu ikur kthetrave shtazarake të njerëzve të dehur deri në çmenduri, të përgatitur për xhenocid mbi shqiptarë. Nëpër mendje më sillej temperamenti i ketij dymbedhjetë vjeçari, i cili pa gdhirë dita zgjohët, kryen të gjitha detyrat që kërkohen nga ai dhe tërë ditën e kalon më moshatarët e vet duke u interesuar edhe për më të ndryshmet gjarje. Nga pamja, gjestet, fjalët, qartë vëreheshin vuajtjet dhe traumat e tij.

A thua, me të vërtetë u çlirua?!

Nuk guxoja te mendoja më tutje, por e dija se për të kurrë nuk do të bëhet më keq. Ngadale dhe si e painteresuar u ngrita dhe shpejt e shpejt e mora një tabletë qetësuese, bensedin, tableta që tani gjindeshin në çantat e xhepat tek shumica e njerëzve. Mora edhe një gotë ujë dhe iu ofrova me të mirë, duke i thënë se po duket i molisur dhe se një aspirin do t'i bëjë mirë. E mori duke u dridhur dhe duke marrë frymë thellë, nga etja për të më rrëfyer përjetimet e tij që i dukej se nuk po i kuptoja fare.
Në lagjen Tavnik u tubuan pothuajse të gjithë banorët shqiptarë të qytetit tonë, të qytetit të njohur të minatorëve – Mitrovicës. Refugjatë të shumtë hynin e dilnin nëpër shtëpi të ndryshme, ashtu siç i diktonin rrethanat për të mbijetuar. Në çdo shtëpi mbretëronte panikë e tmerrshme.
Uhhh!!! Sa e keqe qenka panika e luftës! Natë e ditë të zgjuar çfarë rreziku po na

kanoset, natyrisht, gjithmonë të veshur me rroba rruge, me pak ujë e ushqim futur ne çanta dhe me zemer pezull se ç'do të ngjante më tej. Minuti ishte shumë i gjatë.

5.

Dita e Kurban Bajramit. Për asnjë bajram nuk jemi zgjuar më herët. Në të vërtetë të zgjuar kishim qenë thuajse tërë natën. U ngritëm diku rreth orës tre para mëngjesi. Dyert e shtëpive rrapllonin me të madhe nga banorët e tjerë të lagjes. Ata, të frikësuar, ruanin tërë natën. Me të dëgjuar krisma, mbisundoi paniku dhe për më pak se një çerek ore të gjithë u mblodhëm në rrugë.

Edhe Artin e kisha vënë në gjumë veshur. Kishte fjetur pesë-gjashtë orë. Mjaft mirë për këtë natë. Menjëherë u zgjua dhe brofi në këmbë i gatshëm për çdo gjë që kërkohej nga ai fëmi 3 vjeçar.

- Nanë, po shkojmë me shetitë, a? – më pëshpëriti Arti në vesh, thuase nuk

trembej fare. edhe pse pa rrymë, me një dritë të zbehtë qiriri që arrinte nga koridori. Me fjalë urtie e të pjekura më bënte te fortë, saqë nuk e kisha veshtirë t'ia ktheja përgjigjen që të krijoj një atmosferë sadopak optimiste në këtë gjendje, për të cilën nuk guxonim të mendonim shumë… Ishte e vështirë!

Nga t'ia mbajmë? Të shkojmë tek xhamia e Zhabarit? Tani, atje gjendej një numër i madh njerëzish, sidomos nga lagjja e Bajrit. Bajri ishte një pjesë e madhe e qytetit, e cila tërësisht ishte zbrazur nga ushtria serbe, me ç'rast për çdo ditë digjnin nga një rrugicë. Shumica prej këtyre njerëzve nuk kishin pasur ku te shkonin dhe ia kishin mësy xhamisë, ku nga tollovia e madhe, vinte në pyetje shëndeti i njerëzve.

Si të dehur ecnim nëpër fidanishten e qytetit. Shpesh hasnim nëpër gropa, rrëzoheshim, vazh- donim, prapë rrezoheshim, prapë vazhdonim, derisa u

ndalëm, të gjithë grumbull, në një oborr të një shtëpie që gjendej pak më thellë nga rrugët tjera. U ulëm, të gjithë të frikësuar. Afër trupit ndjeva mbështetjen e Artit, i cili diku larg kishte lëshuar një shikim pyetës. Vetëm zemra e nanës mund ta kuptonte këtë shikim të tij. Asnjëri prej nesh nuk i dukej në gjendje të përshtatshme për të na shikuar. Të vërtetën e kërkonte diku më larg. Ishim plotësisht të humbur. Qëndruam keshtu deri rreth orës 10, kur disa prej nesh vendosem të kthehemi nëpër shtepitë tona. Me t'u kthyer pamë se në atë lagje nuk kishte ndodhur asgjë. Ujë e rrymë kishte. U pastruam nga balta, ndezëm shporetin, dhe njëfarë ngrohtësie shtëpiake, paksa, na qetësoi. Vazhdimisht kuptoja se sa armë e tmershme është përhapja e panikës mes popullit…

Megjithatë, pushimi nuk zgjati shumë. Nga të gjitha anët u grumbulluan njerez dhe thirrnin tëp gjithë të tjerët që të dilnin sa më parë nga shtëpitë, pasiqë rreziku

ishte i madh. Paramilitarë të shumtë ia kishin mësy shtëpive në lagjen Tavnik. Zemrat e të gjithëve ishin plot vrerë e panik. Me të shpejtë veshëm palltot, mbathëm këpucët dhe u nisëm drejt murit të oborrit për të kaluar me ndihmën e një karrige. Kah dera ishim të ndaluar të kalonim pasi që në dukje ishin snajperistët e vendosur mbi soliteret përtej rruge, të cilët në çdo lëvizje gjuanin.

Prapë u mblodhëm në oborrin e shtëpisë ku ishim më herët. Të zotët e shtëpisë bënë vende për të gjithë, në të tri shtëpitë e mëdha që i kishin. Na gostitën të gjithëve me drekë të Kurban Bajramit, si dhe me çaj të ngrohtë. Nuk do të harrohet kjo drekë bajrami tek familja fisnike e Kamberajve. Sa me ëndje piu Arti atë supë që m'u duk se krejt e keqja nga unë humbi, pasi që e dija se Arti nuk ishte i uritur. Me të rënë muzgu, prapë u shpërndamë nëpër shtëpi.

Nuk e di a ia uruam festëen e bajramit njeri- tjetrit, por e dii se këto dy festa të

Bajramit sivjet më kaluan thuajse të njejta. Në ditën e Bajramit të Madh më vdiq babai dhe e varrosëm. Sa e rendë ishte humbja e prindit! Mërzia dhe dhembja ishin edhe më të mëdha kur e dija se vdekja i erdhi më herët nga zemërimi për fshatin e tij, Vidishiqin, që aq shumë e deshti, e të cilin disa ditë më parë forcat serbe e kishin djegur të tërin. Me këtë rast kishin vrarë shumë kusherinj të tij, e, në mesin e tyre, edhe Xhevat Jusufin legjendar, që aq shpesh e vizitonte dhe këshilloheshin për më të ndryshmet.

Pas ditës së Kurban Bajramit, dhjetë ditë me rradhë, ditën kalonim të tubuar në fidanishtën e qytetit, ndërsa natën ktheheshim nëpër shtëpi.

Përkundër rreziqeve të shumta, e që për çdo natë ndriqonte, si me vaj, flaka e shtëpive të shumta që digjeshin pamëshirë nga policët dhe paramilitarët serbë, llahtaria u zvogëlua dhe nga shtëpitë nuk dilnim.

Për çdo ditë plaçkitje, bastisje, djegie, vrasje... Gati e tërë familja jonë e gjerë ishim mbledhur në të njejtën shtëpi. Secili prej nesh mundoheshim të siguronim ushqim, madje, për disa ditë, pasi që shpresonim në fitore të sigurt dhe në largim sa më të shpejtë të këtyre krijesave që nuk po mundemi me i definue me tej. Ndër ethe, shpesh, kalonim urën e Ibrit, në pjesën veriore të qytetit, për të blerë ndonjë artikull të nevojshëm në dyqanet e furnizuara për mrekulli, derisa dyqanet që gjendeshin në këtë anë të urës, ku ishte koncentruar popullsia shqiptare, në tërësi ishin plaçkitur dhe djegur nga policia serbe. Edhe unë, për shkak të Artit, shpesh rrezikoja dhe kaloja urën për të siguruar ndonjë litër qumësht. Kështu veproja shpesh, derisa një ditë u detyrova te kthehen nga gjysma e urës, pasi që vëreja se çfarë ndodhte në anën tjeter të urës. Nje grup i grave sërbe mbanin gjëra të ndryshme ne duar, si drunj, garuzhda,

shkopinj gome, gurë e të ngjashme dhe nuk lejonin te kalohej në anën tjeter te urës. Grave shqiptare që kthehesin nga ana tjetër për në shtëpitë e tyre, ato gra ua merrnin të gjitha gjërat e blera dhe i rrahnin pa mëshirë. Natyrisht, pas tyre, aty-këtu, dukeshin policë serbë, të armatosur deri në dhëmbë. Çfarë mund të thuhet për ato gra?... Shumica prej tyre i thoshin vetes nanë! A mund t'u thuhet atyre grave nanë?! Plaçkitnin qumështin e foshnjave shqiptare që, ndoshta, me ditë të tëra ishin tharë për ndonjë pikë. Jo! Ato nuk mund të quhen nana. Nanat e vërteta nuk edukojnë fëmijët e tyre qysh në bark, pa u liruar fare, që t'a urrejnë një komb, një komb shumë fisnik, vetëm pse ekziston, siç bëjnë gratë sërbe kundër kombit shqiptarë. U ktheva në shtëpi me veshtiresi të mëdha, pasi që nga çdo anë ishin bllokuar rrugët nga policia dhe ushtria sërbe, ashtu që u detyrova të kaloj kah mëhalla e romëve, shumë e lumtur që

gjeta një shteg, edhe pse mjaft të pasigurtë. Romtë ishin më tepër se sa lojal në shërbim të sërbëve. Flitej se, shumë prej tyre, bënin gjëra të paimagjinuara ndaj popullit tonë, në shërbim të sërbve. Duke ecur, mendoja se po të bashkohesha edhe një herë me fëmiun tim, kurrë më nuk do të ndahem prej tij. Nga këto mendime dhe nga kjo frikë, kur arrita tek Arti, nga djersa isha bërë sikur të isha futur e tëra në ujë. Vendosa të mos dal më në qytet për asgjë.

A thua do të kem ushqim të mjaftueshëm për Artin? Nuk e di. Sikur të ishim me babain e tij, sigurisht do ta kishim më lehtë. Tani nuk kisha kurrfar shprese se do të vinte, pasi që rreziku ishte i sigurt. Fatmirësisht, ushqim të mjaftueshem Artit i siguronte daja e tij, Enveri, i cili, aq sa kishte mundësi, depërtonte nëpër rreziqe, që të mos vuajnë për ushqim, bile fëmijët.

Një mëngjes, fillim prilli 1999, rrugica të shumta ishin mbushur me njerëz të përgatitur për udhëtim. Shumica ishin ngarkuar me valixhe. Kah po shkojnë!? A është e mundur që të zbrazen shtëpitë me një intensitet kaq të madh? Ndoshta do të ndalen…

Jo! Çdo mëngjes turma të mëdha njerëzish ecnin për në stacionin e autobusëve. Biletat i siguronin një ose dy ditë më parë, për shkak të tollovisë së madhe. Rendit të autobusëve nuk i dukej fundi, duke gëlltitur njerëz pa mëshirë, për t'i bartur kudo, vetëm që të mos i lënë këtu. Të tmerruar shikonim se si zbrazej Mitrovica, e për qytetet tjera flitej se veq ishin zbrazur. Kjo gjendje zgjati pothuajse 5-6 ditë, deri sa një pasdite pashë njerëz që kthehesin nga stacioni, meqenëse autobusët më nuk udhëtonin. Nuk dinim se çka po përgatitej tani e tutje për ne, por e di se bukur mirë u qetësova. Ndoshta dikush do të mbetet...

6.

Nuk na e merte mendja se do të na ndjekin nga ky mes. Por, ndodhi edhe kjo. Një ditë me plot re në qiell, rreth orës 13, e mërkurë 14 prill 1999, forcat serbe u duken edhe në oborrin tonë. Çdo herë dhe në çdo moment i kishim pritë më shumë sesa tani. Petët e pitës mbetën të tëholluara mbi tavolinë. Ndoshta i ka mallkuar ai bereqet! Të gjithë, me shpejtësi, morëm nga një a dy valixhe të përgatitura më parë me ca gjera të nevojshme dhe ia behëm kah rruga kryesore, ku dukej një turmë shumë e madhe e njerëzve. Unë mendova vetëm në Artin, të cilin e shtrëngova fort për dore, kurse në dorën tjetër mora ushqimin për të. U nisëm me automate të drejtuara në shpinat tona. lu bashkangjitëm turmës së madhe. Nuk dinim kah shkonim. Gjithnjë, shpresonim se pas disa orëve do të kthehemi prap nëpër shtëpitë tona, siç ndodhi shumë herë më parë. Në të

vërtetë, as këpucë nuk kisha mbathë. Dola me të mbathurat e brendshme të shtëpisë. Por, si duket këtë herë, nuk ishte ashtu.
Ecnim me shpejëtsi aq sa na lejonte turma e njerëzve. Nganjëherë, ndaleshim për t'u nisur menjeherë, nga krismat e automatikëve, si vërejtje që të mos ndalemi, dhe duke përsëritur ku me e ditë për të satën herë. "U Albaniju, idite u Albaniju!" ("Në Shqipëri, shkoni ne Shqipëri!").
Po na thonë të shkojmë në Shqipëri?! Në Shqipëri?! Po, si të shkojmë kështu?! Këmbë?! Po bie shi. Qysh tani, kur ende e kemi në dukje shtëpinë, këmbët na janë bërë qull të lagëta.
Jo more, çfarë Shqipërie? – Dëgjoheshin gjith- farë komentesh, derisa disa ishin hypur nëpër vetura dhe traktorë të gatshëm për ta vazhduar rrugën kah tu shohin sytë, e sigurisht për në Shqipëri, natyrisht, me plot frikë nga maltretimet dhe vrasjet mizore që beheshin në çdo moment.

E ne? Ne që ecnim nëpër baltë, ç’të bëjmë? Ndoshta do të largohen këta përbindësha, dhe sadopak do të qetësohen rrugët që të kthehemi në vatrat tona.
Vështirë e kishim në këto momente të gjejmë strehim. Vazhduam kah fshati Zhabar. Tjetër zgjedhje momentalisht nuk kishim. Kur arritëm te shtëpitë e para të këtij fshati, filloi te bjerë muzgu. Nëpër çdo shtëpi, si hije të errëta, vlonin njerëz të dëbuar që nuk kishin ditur kah t'ia mbajnë dhe ia kishin mësyre ndonjë miku apo, sadopak, të njohuri të këtij fshati. Siç duket, as këtu nuk paskemi vend. Vazhduam rrugën përmes fshatit për të arritur tek nje mik i të ndjerit baba. Aty, menjëherë, na ofruan strehim dhe mikëpritje, edhe pse kish disa muaj që kishin disa refugjatë dhe iu kishte hyrë frikë e madhe për mungesë ushqimi. Në këtë shtëpi qëndruam dy netë duke shpresuar se do të kthеheshim nëpër shtëpitë tona. Më kot. Në të vertetë, natën

e dytë, u vendosëm në një kamion për t'u nisur për në Shqipëri, por shoferi nuk pati guxim të nisej në muzg për ta zënë kolonën, e cila ishte nisur dhe larguar bukur shumë, kështu që, u arsyetua se si motori i kamionit nuk ishte në rregull. Ndër njerëz dëgjoheshin komente të ndryshme, se si po kërkon para për çdo udhëtar, edhe pse nuk deklarohej. Si do që të jetë, ne u detyruam që të zbrisnim për ta kaluar natën prap në të njejtën shtëpi. Brengën më të madhe e kisha tek Arti, i cili tërë natën e kërkonte babanë në gjumë dhe për nga shëndeti e vëreja se nuk është mirë. Mundohesha të mendoja sa më pak për vështiresitë e situatës në të cilën gjendeshim.

Të nesërmen, ditën e tretë në këtë fshat, policë sërb të armatosur, thuase po luftojnë me një planet të tërë, u paraqitën edhe në pragun e shtëpisë në të cilën gjendeshim. Dolëm menjëherë. Na grumbulluan në magjistralën që gjendej afër. Të grumbulluar na mbajtën rreth një

orë, duke qëndruar para nesh mbi tanke dhe autoblinda. Pandërprerë provokonin me gjithfarë fjalësh. Dikur na drejtuan kah fshati Shipol, i cili nuk ishte aq larg prej aty. Para syve tanë tym e flakë. Digjej Mitrovica. Të mbushej mendja se asaj flake nuk i ka shpëtuar asgjë pa e djegë. Edhe fshatrat përreth saj digjeshin. Me shpirtëra të thyer qëndruam kështu tërë ditën, në një lëndinë afër shkollës së fshatit Shipol, duke pritur se çdo të ndodhte me tej me ne. Kthim për ne nuk kishte. Shpresonim të vazhdojmë për Shqipëri apo për Maqedoni me ndonjë bartje pak a shumë të organizuar, me ndonjë autobus apo automjet tjetër, bile për pleq e fëmijë. Kështu, në shi e në erë, të humbur në këtë botë, na zuri terri. U afruam tek një mur tarabash dhe vendosëm që aty t'a kalojmë natën, pasi që edhe shiu pushoi. Artin menjëhere e zuri gjumi. E mbështolla mirë me batanien që e bartëte per të Edini, tezaku i Artit, dhe më dukej se edhe

shpirti im pushonte i qetë, duke vështruar fytyren e tij të pafajshme sikur engjëll. Ndoshta, engjëjt e këtyre fëmijëve do të na mbrojmë. Së paku, këta janë pa mëkate. Na u duk se sadopak u rehatuam. Përnjeherë, filloi një shi i madh. Me të shpejtë rrëmbeva Artin para duarve dhe u vendosa në një nga shtëpitë e fshatit. Deri atëherë nuk guxonim të hynim në asnjë shtëpi nga rreziku i djegies së fshatit. Arti vazhdonte të flente, kur papritur mua ma tërhoqën vërejtjen se kjo shtëpi është e rrezikuar, pasi që forcat sërbe ishin të stacionuara në një barakë në afërsi të saj. U detyrova ta mbaj prap Artin para duarve dhe nëpër terrin e zi me shi e pa hënë, nëpër gropa të ndryshme që nuk vëreheshin, e që rreziku per t'u rrëzuar ishte i madh, kërkoja ndonjë strehim tjetër. Vështirë! Në shtëpitë e afërta nuk kishte vend më për askend. U vendosa nën një ballkon të një shtëpie, edhe pse, edhe aty, mjaft me vështirësi. Afër murit tani veç

ishin vendosur njerëz, dhe mezi gjeta vend. Tërë natën qëndrova e kërrusur mbi Artin, që ta mbroja nga shiu dhe nga era. Ishte natë mjaft e gjatë. Brenda, në këtë shtëpi, gatuanin bukë gratë, dikush të grurit e dikush te misrit, varësisht në çfarë mielli kishin hasë.

Diku pas mesnate arritën disa burra për të marrë bukë për njerëzit tanë që gjendeshin në male, të cilët edhe pse me armatim te dobët, ia shtinin tmerrin dhe çmendurinë armikut.

Me vonë kuptova se ata që më larguan nga shtëpia ku isha vendosur për ta kaluar natën, me arsyetim se rreziku ishte i madh, tani ishin vendo- sur vet.

7.

Ditë e re. Ç'do të bëjme sot?! Shikoj fytyrat e të gjithëve me radhë, ndoshta kuptoj diçka më tepër.

Arkivi I Kosovës/ Kosova 1999/Foto nga Paul Refsdai_Gazetar Norvegjez

Por, jo. Ato ishin të njejta, pa kurrfarë ndryshimesh nga dita e mëparshme. Pa kurrfarë· iniciative për të ndërmarrë diçka të nevojshme. Pasi që brenda, shporeti ishte më pak i ngarkuar, shpejt e shpejt propozova t'a gatuajmë edhe një tepsi me gurabia, ushqim i përshtatshëm për rrugë. Shumicën e gjërave të nevojshme për gatimin e tyre siguruam nëpër shtëpinë ku ndodheshim. Sa mendonim se siguruam sadopak ushqim, shpejt harxhohej. Çfarë të bëjmë? Burrat që gjendeshin me ne, u munduan, përmes disa miqve që gjendeshin aty, t'a siguronin ndonjë autobus. Edhe kjo përpjekje dështoi. Qartë dukej se çdo minut i mëtejmë qëndrimi, për ne bëhej vonë, dhe vetëm na

shtohej edhe më tepër paniku e trema, me ç'rast edhe fuqia ngadale na lëshonte. Nuk na mbeti kurrfarë rrugëdalje, vetëm të nisemi këmbë për në Shqipëri.

Për në Shqipëri, me fëmiun tre vjeçar! Këmbë! Babanë nuk e ka këtu. A do të mund t'a barti ndonjeherë, nëse nuk mund të ecë në rrugë të gjatë. Mot me shi, që po rrjedhë herë pas here nga retë e dendura, që më dukej se kurrë nuk i kisha parë kështu, grumbuj-grumbuj. Më dukej se donin të na përbinin. Toka e tëra ishte bërë baltë.

Nuk e di as vet si më shpërtheu britma:

- Ç'po prisni?! Nisemi! Çdo minut më vonë, aq më keq për ne. Nisemi!!

Propozimi hasi në mirëkuptim, sikur ta kishin pritë këtë gjë, e që askush nuk kishte forcë e guxim ta thoshte.

Rreth orës njëmbëdhjetë e tridhjetë minuta u nisëm. Nga koka, me vetëdije i largoja të gjitha mendimet që më silleshin vërdallë për rreziqet e mundshme gjatë rrugës, që anembanë i kishin përfshirë

militarë e paramilitarë sërbë. Nëpër mendje solla datën 17 prill 1999. Ditën e sotme kur ia mësymë Shqipërisë; Kur po ia kthejmë shpinën Kosovës. A do të kthehemi ndonjëherë? Më mirë të mendojë a do të arrijmë të gjallë në Dheun Amë.
Ende pa kaluar njeqind metra, Arti rrëshqiti dhe përbalti pantallonat. Edhe një palë tjera i kisha me vete por nga ankthi, frika dhe shqetësimi, vazhdova si arsyetim në vete se nuk kisha kohë t'ia ndërroja. Një çadër e shtrembër na i priste pikat e shiut, të mos na e lagin, së paku, tapën e kresë. Me të vërtetë u nisëm në rrugën për Shqipëri; në shpëtimin tonë – nëse ai është i mundur. Kjo mundesi shpëtimi, përkunder të gjitha vështirësive, mundimeve me rrezikun e pandërprerë, ndriçonte, edhe pse shumë zbehtë, vetëm në këtë rrugë.

Arkivi I Kosovës/ Kosova 1999/ Foto nga Paul Refsdai_Gazetar Norvegjez

Mjaft të mërzitur, filluam rrugën kështu rreth njëqind vetëve. Pak më tutje, numri shumë shpejt arrijti rreth gjashtëqind vetë. Krahas nesh ishte vargisur kolona e traktorëve dhe e qerreve të ngarkuara nga njerezit me shikime të dehura e të humbura, pa ditur saktësisht se çka po ndodhë me ta. Ashtu të humbur, mezi fshehnin shikimet e tyre, duke i larguar sytë nga shikimet tona, sigurisht lakmuese, për të gjetur edhe në ndonjë skutë në qerret e mbingarkuara të tyre.

Arkivi I Kosovës/ Kosova 1999/ Foto nga mediat

O Zot! A do të ndalet ky shi ndonjëherë apo do të vazhdojë kështu tërë kohën? Përkundër këtij moti, të gjithë që gjendeshin pa transporte, na bashkangjiteshin me një disponim, thuajse e gjetën shpëtimin. Numri i kolonës vazhdimisht rritej.

Me zë mjaft vajtues, përnjeherë, shpërtheu vaji i Artit. Britma e tij ishte paksa e çuditshme. Ishte me takte që kuptoheshin mjaft mirë. Asnjëherë deri më tani nuk e kisha dëgjuar duke qarë kështu. Të gjithë e dëgjonin, e kuptonin dhe heshtnin. Asnjëri nuk mundohej t'a ngushëllonte.

As unë. M'u duk se po shprehej zemra ime. Më së miri e kuptonte Gëzimi, shoku i tij i dajëve, me të cilin kalonte kohën më të madhe. Ishte dy vjet më i madh se Arti. Edhepse mbahej dhe nuk qante, lëvizjet e tij na shqetësonin të gjithëve. Edhe Gëzimit ia shtërngonte dorën nëna e tij Zoja.
Edhe të tjerëve u vajtonte zemra, dhe mezi pritën kur dëgjuan këtë vaj.

- Po qanë për tokën e vet dhe për shtëpitë e braktisura, u degjua zëri i gjyshës se Artit, nanës time, Miradies, që shumë mirë e kuptonte zemrën dhe vajin e tij. Kjo grua gjashtëdhjetëenjëvjeçare, për të dytën herë perjetoi të udhëtonte nga Kosova në Shqipëri. Në të dy rastet me dhunë. Herën e parë në vitin 1938, kur ishte vetëm gjashtë javëshe, duke ikur nga i njejti okupator barbar. E bartëte para duarve nëna e saj, hipur në kalin që e terhiqte babai i saj, Bislim Bajgora, të cilin aq shumë e kërkonin që ta vrisnin.

Nana Miradija – e bija e Bislim Bajgores

Pas tri vjetësh qëndrim në Gjirokastër, në vitin 1941, kjo familje u kthye në Kosovë që të shetisin lirisht nëpër rrugët Dardane, ashtu siç publikohej lirisht, për herë të parë në historinë e Kosovës – Abetarja në Gjuhën Shqipe. Babai i saj, Bislim Bajgora, me bashkëvendasit e tij …

Ulur: Bislim Bajgora, Hajdar Pllaneja , Kole B. Markaj Ne kembe: Halim Orana, Bedri Gjinaj, Selman Riza, Sokol Dobroshi, N.N., Emin Bajgora, Ajet Gerguri, Azem Marana (Nga Albumi Familjar)

Vazhdoi të luftonte për idealet e Kosovës së lirë, si në Kosovë ashtu edhe më gjerë (Sanxhak; Rreth-Shkodre…), me ç'rast, në vitin 1947, i rrethuar nga serbët e etur për gjakun e tij kishte shkrepur automatikun ne fytyrën e tij, që edhe për së vdekuri të mos ia shikojnë të qetë fytyrën. Tërë jetën luftoi. Luftoi dhe u vra për Kosovën, që bija e tij të mos dëbohet më.

Bislim Bajgora, ulur nerreshtin e dyte nga e majta Ne kembe nga e majta prapa

Bislim Bajgora me Behë Qerim Imeri, kurse ipari në këmbë nga e djathta: Behë Zekë Muja (Nga albumi familjar)

A thua pse po na përsëritët historia? Pseee?! Ëndrra e tij ende nuk u realizua. E bija iu dëbua në mënyrën më brutale me fëmijët e saj, me nipat e me mbesat. Për fat të mirë nuk po i ndahet dhe po i gjendet në çdo moment e bija, Afërdita.

Arti dërmiste nga lodhja e nga të qarit. Vallë, a do të kthehet rnë ky fëmijë në Kosovë? As që guxonim të pyesnim, pasi që nuk e dinim se çfarë po ndodhë me ne. Ne fakt, as kohë nuk kishim. Në ne

kishte hyrë droja se a do të mund të kalojmë kësaj rruge me rrezik. Nuk mendonim për dëbim, por vetëm për ekzistencë dhe si të kalojmë të gjallë. A ka ndodhur ndonjeherë në histori të dëbohet një popull i tërë, t'i digjen shtëpitë, që të mos ketë më ku të kthehet, minutë pas minute t'i kërcenohet jeta, e në të njejtën kohë t'i ndalohet kalimi…

Tërë kohën dëgjoheshin komente për kolonat para nesh; për peripetitë e tyre; për ndarjen e mashkujve; arrestimin dhe vrasjen e tyre; për bastisjen dhe rrahjen e grave; për përbuzjen; fyerjen; çnderime e grabitje të femrave, vrasje të shtazëve... E, më në fund, prapëseprap moslejimin e kalimit të kufirit. Rrallë ndonjë banor i qytetit të minatorëve, qytetit të Mitrovicës, nuk e kishte këtë fat. Gjenocid total!

Dy kolona para nesh i kishin detyruar të kthehen gati në hyrje të kufirit, pa kurfar transporti, prap në këmbë. Disa të tjerë kishin kaluar. Ndoshta edhe ne do ta kemi,

bile, pak fat të arrijmë të gjallë dhe t'a kalojme kufirin.
Dielli filloi dalngadalë t'i nxjerrë rrezet e veta të prillit nga retë e dendura. Asfalti thahej, bashk me rrobet në trupat tonë. Të gjithë ndjemë njefarë lehtësimi. Zoti na e lehtësoi ecjen.
Zhurmë makinash të traktorëve dhe qerreve të renditura njëra pas tjetrës. Mësuam se pas nja dy orëve, që ishim nisë, ishte nisur kolona e tyre në të cilën gjendej edhe kamioni, ku dy netë më parë ishim vendosur për të udhëtuar. Tani ai kamion ishte i mbingarkuar, kurse shoferi 'nuk' na njihte fare.

Foto-huazuar nga mediat

Vërtetë, ishim në gjendje shumë të mjerë. Mua nuk më dukej krejt zi. Më dukej vetëm një mënyrë vuajtjeje më primitive sesa ato

të represionit serb që zbatoheshin më parë. Nuk e di që prej, sa di unë, gati njëzet vjetësh me parë, a kemi qenë më mirë. Çdo herë arrestime, vrasje, dëbime nga puna, përdhunime, maltretime, gurbet, gurbet, gurbet. Gurbet, me metoda që as lapsi as goja nuk mund t'i shprehin, dhe asnjë popull nuk mund t'i kuptojë ato metoda nëse nuk i ka ndjerë në lekurën e vet. Askush, pos ne shqiptarëve të Kosovës, nuk do t'a kuptojë dhe nuk do t'a dijë shtypjen që kan përdorë sërbët ndaj nesh. Këto metoda të ndryra, jam e sigurtë se askush në botë nuk di t'i përdorë përpos okupatorit tonë. Për këtë arësye, përkundër një situate të tillë që gjindeshim, thellë në shpirt ndjeja një lehtësim të çuditshëm. Ndjeja fundin e zbatimit të metodave speciale të tyre dhe kalimin në metoda primitive, që i kupton çdo njeri në botë e që nuk janë më të rrezikshme se të parat, për një popull të lashtë që ka përballuar gjithfarë okupimesh dhe e kanë njollosë me

gjithfarë epitetesh, duke shtrembëruar dhe duke i dhanë kahje-gënjeshtër historisë. Edhe jeta në kolonën e tillë, ndonjeherë qenka më e mirë sesa jeta e perditshme në okupim.

- Nanë, ku po shkojmë? – shumë shpesh më ndërpriste Arti nga mendimet.

- Kur do të kthehemi në shtëpi? - vazhdonte me pyetje, gjithmonë me vaj në buzë.

Çfarë t'i them. A jam në gjendje t'i përgjigjem në menyrë të arsyeshme, e njëkohësisht, të mos ia thyej vullnetin fëmijëror, të mos ia dëmtoj ëndrrat e pastërta fëmijërore.
Doemos duhet të gjeja fjalë të mira që do t'i japin shpresë e forcë. Arti duhet të qëndrojë! E dija mirë se tërë kohën i duhet me ecë.

- Nanë, ku po shkojmë? - më pyeste me kurreshtje.

- Po shkojmë tek një fushë e madhe me plot lule ngjyra-ngjyra.

Përnjeherë, m'u kujtua se sa i do Arti lulet. Dhe me të vërtetë një përgjigje e tillë pat efekt. Ndjeva një buzëqeshje të ëmbël, të befasuar, dhe sikur donte të më pyeste prap.

- Po, a? E, kur? A ka edhe shumë? – pyeste…

Si është e mundur që fëmiu trevjeçar t'a kuptojë situatën kaq qartë. Si duket, ky fëmijë, nga fillimi i krijimit të vet i është eksponuar represionit okupues dhe shumë lehtë e kupton dhunën e pushtuesit.

- Art, ec më shpejt! Më së shpeshti i drejtohesha me këto fjalë. Meqenëse nuk kisha forcë për të folur, shumë shpesh pështpërisja vargje këngësh….

8.

Në krye të kolonës ka njerëz të fuqishëm. Disa pa fëmijë të vegjël dhe pa pleq. Kah fundi mbeteshim ne që kishim fëmijë më të vegjël, si dhe njerëzit më të vjetër. Disa ishin të sëmurë. Për fat, shumica kishin mirëkuptim dhe ngadalësonin hapat për t'na pritë. Shpesh kolona ndahej në dysh, madje edhe në tri pjesë. Disi, prapë bashkohej.

Ecnim nëpër Drenicën legjendare. Nëpër Drenicën e zbrazur qysh para motmoti.
Çdo shtëpi ishte e djegur. Punkte të vargisura me plot militarë e paramilitarë serb. Në çdo hap na përcillnin, disa duke u tërhequr, e njëkohësisht të tjerë duke dalë sikur larashë, të gatshëm për çdo lloj maltretimi, deri tek masakrat më çnjerëzore ndaj një populli të pa armatosur, ndaj fëmijëve, grave e pleqve, që kërkonin vetëm të kalonin rrugën, për t'a shpëtuar jetën, asgjë tjetër. As këtë nuk ishin të gatshëm t'a lejonin.

- Ky është Përroi i Keq, - tha dikush kur ishim duke kaluar kah mesi i Drenicës. Në dukje u shfaq nje veturë e tipit mercedes, me ngjyrë të gjelbër, me shprejtësi trishtuese. Përnjeherë frenoi para këmbëve tona. Dy persona me veshje civile e me automatikë, të drejtuar kah ne, dolën si të tërbuar, duke bërtitur që të ndalemi. Dukeshin sikur bisha të çmendura, të etshëm për gjak. Kolona ishte e ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë kaloi pa u verejtur. Neve na u drejtuan me gjithfarë fjalësh fyese, duke n'a kërcënuar se do të na pushkatonin nëse nuk e dhamë gjithë pasurinë që e mbanim me vete, ari dhe para. Mblidhnin sa mundnin, gjithmonë duke u kërcënuar dhe duke i qëlluar të gjithë me radhë me kondak automati në kokë.

Unë, nxora të gjithë dinarët që i kisha në qantë dhe hoqa zinxhirin e arit që kisha në qafë. Atë e bartja me qëllim për raste rreziku. Njëri prej tyre i rrembeu si bishëhumnere, duke i shikuar. U tërbua

edhe më shumë duke sharë pse paratë nuk ishin në marka, por në dinarë. Shumë mirë e dinte se ç'vlerë kishte dinari i tyre, aq sa kishin vlerë edhe ata vet. Mori hov dhe, me tërë forcën, më goditi me kondak pas kreje, që shpejtë e largova pak që të mos ishte goditje direkte. Artin e kisha për dore. Dora e tij më dha forcë të mos rrëzohesha. Të afermit e mi vrapuan dhe nxorën pasuri që kishin për t'i larguar sa më parë nga unë. Kështu vazhduan deri në fund të kolonës.

- Ti je doktor, apo jo? - iu drejtuan Dr. Shaqir Demirit dhe e ndanë prej kolone. Fëmijët e tij Edini dhe Kujtimi filluan të luteshin dhe të qanin. Edhe shoqja e tij, motra ime Dr. Sanija, nxori tërë pasurinë, që kishte në ari dhe në para dhe ua dha, duke i lutë që t'ia falin jetën. Edhe pse e rrahën dhe e plaçkitën, deshti fati e lëshuan të gjallë...

- Mua, dalëngadale, pas nja një çerek ore m'u kthjellua të pamurit, që m'u dobësua nga goditja e tyre.
- E sheh ç'po n'a bëjnë?!, - m'u drejtuaDr. Shaqiri.
- Goxha moti më mirë nuk kemi qenë. Pa u bë kështu, nuk bëhet mirë. Kryesorja, të shpëtojmë gjallë, - ia ktheva.

Dhe, në të vërtetë, kështu ndjehesha. Asgjë më mirë, nga ato qenie, nuk prisnim. Vetëm të kalojmë të gjallë.

- Nanë, pse të qëlloi? - më në fund mori guxim Arti të më pyeste, e të cilin vazhdimisht e shikoja se çfarë reagimesh tregonte. Bëhej sikur nuk hetonte asgjë, kështu që u habita kur ma bëri këtë pyetje. Thuase e kishte pritur atë gjë prej tyre, si një gjest normal të tyre. Edhe ai, ishte i gatshëm të priste çdo gjë prej tyre.
- M'u kishte prishur frizura dhe ma rregulloi pak - ia ktheva unë si e painteresuar për pyetjen e tij. Kjo pyetje më goditi shumë më shumë sesa goditja e

automatikut. Thjesht ë vërehej se kuptonte tërë situatën, si çdonjëri prej nesh.
Ecëm edhe pak dhe arritëm pjesën tjetër të kolonës, që ishte ulur të na priste, që të pushonim edhe ne, me ç'rast pushimi i tyre mbaroi me të arritur ne. Vazhduam të gjithë...

9.

Ra muzgu i ditës së parë të udhëtimit tonë. Na kishte kapluar lodhje e madhe. Tek fëmijët dhe pleqtë qartë vëreheshin rezervat e fundit të forcës.
Pamje e tmerrshme dukej në cep të një rruge. Dy pleq të sëmurë dhe të molisur nga lodhja, kishin braktisur kolonën dhe i ishin dorëzuar stihisë së fatit, në flakë të kësaj lufte të ndytë që më së shumti po i goditë gratë, pleqtë e fëmitë. Gjëra trishtuese po ndodhin në këto anë, kah jemi duke kaluar ne, që truri i shëndoshë assesi nuk është në gjendje t'i pranojë dhe të besojë se po ndodhin; rrahje, plaçkitje,

maltretime, vrasje, masakrime të çdo lloj fryme. Vallë, çfarë peripetishë po i presin këta dy pleq të ndarë nga kolona në natën që po bie, e që neve po na duket se po bie shumë shpejt.

- Ujë, ujë! - kërkonte Arti shumë shpesh. Që nga kroi i Broboniqit nuk kemi hasë në ujë të pishëm.

Ku do të ndalemi t'a kalojmë natën? Duhet t'a largojmë frikën e të ndalemi diku. Ku? Asnjëri nuk dinim.

- Nanë, ku po shkojmë? - pyeti prap Arti.

- Po shkojmë në fushën e gjerë me plot lule ngjyra-ngjyra, të kuqe, të bardha…, përgjegje të njejta... Mundohesha t'u përballoj pyetjeve të tij. Nga dhembja, nuk e shikoja fare. E tërhiqja për dore dhe mezi përgjigjesha. Asgjë nuk më sillej nëpër mendje pos mundësisë sesi të qëndroj dhe t'i ndihmoj fëmiut tim trevjeçar, të shpëtonte i shëndoshë, fizikisht dhe psiçikisht.

- Natë.

- Unë jam filan fisteku nga fshat i Çubrel. Jam ushtar i UÇK-ës. Përnjeherë na doli përpara një i ri rreth njëzetëepesëvjeçar, të cilit ia harrova emrin nga habia, etja dhe lodhja. Ishte momenti i parë pas shumë ditësh që mora frymë lirisht. Po, me të vërtetë ashtu ishte. Edhe pse na njoftoi për shumë rreziqe nga forcat paramilitare sërbe, madje, edhe nëse e ndezim vetëm cigaren, ai djalosh shumë na e lehtësoi lodhjen. Ishte ngritje morale për të gjithë ne, edhe pse shumë mirë i njihnim, në rrethanat e egzistuese, mundësitë e UÇK-së. Për ne, posaçërisht për mua, UÇK-ja kishte domethënie të madhe. Shumë mirë e njoh dhe qartë e kujtoj reagimin e disponimin tejet frikacak të serbëve kur dëgjonin për formimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Çfarë lehtësimi për ne shqiptarët në organizatën punuese kur u formua kjo ushtri, që në zemrën time do të mbetet gjithmonë, e në

popullin tonë as nuk do të harrohet as shuhet kurrë.

Arkivi I Kosovës/ Kosova 1999/ Foto nga Paul Refsdai_Gazetar Norvegjez

- Po hyni në fshatin Çubrel! - vazhdoi zëri i ushtarit tonë. Nja 200 metra prej këtej kthehuni në të djathtë. Atje ju presin njerëzit tanë. Do t'a kaloni natën në shtëpitë që gjenden aty!

Vazhduam sipas urdhërit. Kushtet ishin mjaft të vështira. Shtëpi pa dyer dhe pa dritare, me shkujë te hatashme. Mirëpo, prapëseprap, moralisht ishim mjaft më të fortë. Kjo ndikoi të forcoheshim psikikisht, e madje edhe fizikisht. Artin, shpejt e mbështolla me batanien, që gjithnjë për te e bartëte Edini. E mbulova edhe me pallto mirë, që për te e bartëte gjyshja e Artit.

Flinte mirë. Ne të tjerët, të strukur, u mbështetëm disi nëpër kashtën e vendosur për ne. Menjëherë filluam të kotemi.

- Zgjohuni, shpejt zgjohuni, nisemi! - na trembën disa zëra rreth orës një pas mesnate.

- Duhet te vazhdojmë! - vazhduan të thërrisnin të njejtët zëra nga oborret e këtyre shtëpive.

Shpejt e shpejt u ngritëm nëpër terr, mblodhëm ato gjëra që kishim me vete. Artin e mora para duarve, me shpresë se do të bënte edhe ndonjë çast gjumë dhe dolëm në oborr.

Në oborre të këtyre shtëpive ishin tubuar njerëz të një kolone tjetër, të cilët kishin arritur në ato momente. Tani kolona ishte rritë, dhe numri kishte arritë në rreth 2,500 njerëz, të të gjitha moshave…

- Duhet te vazhdojmë, duhet te vazhdojmë! bërtisnin.

Si t'a zgjoj Artin? E dija shumë mirë lodhjen e tij. Flinte shumë ëmbël.

Vazhdova t'a mbajë para duarve, duke ecë me hapa të shpejtë, për të mos iu ndarë turmës së njerëzve që aq pak dukeshin në këtë natë të errët pa hënë. Ndjeja si më lëshonte fuqia dhe nuk mund të vazhdoja më. Kaluam kështu 600-700 metra dhe u ndalëm në rrugën kryesore, kah edhe duhej të ecte kolona, natyrisht, nëpër vijën e tërhequr që e kishin vizatuar për në. Nuk e di kush. Deshti fati dhe u ndalën që të grumbullohen të gjithë. Unë shfrytëzova rastin dhe menjëherë u ula në rrugë, gjithnjë me Artin para duarve. Ndoshta mundem me e zgjatë edhe ndonjë çast për gjumin e tij. Pas meje vërejta që shumica e njerëzve, e sidomos gratë dhe fëmijët u ulën nëpër valixhet që i vendosën në rrugë. Pas disa çasteve u grumbulluan të gjithë. Dikush tha se është më mirë të presim agun e mëngjesit. Të gjithë, thuase e kishin pritur këtë fjalë, dhe u ulën aty ku gjendeshin.

Bënte ftohtë.

- Mos ndezni cigare! - ku me e ditë për të satën herë përsëriteshin këto fjalë, për shkak të rrezikut nga gjuajtjet e armëve të paramilitarëve sërb, për të cilët thonin se në këtë kohë të gjithë janë të dehur nga pijet alkoolike.

Ktheva kokën mbrapa, nga vinin krismat e krandeve, dhe pashë sesi shpërthenin zjarret një nga një. Zjare të mëdha, ku afroheshin njerezit për t'u ngrohur ngapak. Përkunder rreziqeve që mund të ndodhin nga drita e flakës, shumica vetën e ndjenin te vdekur nga rreziqet e mëdha që kanoseshin nga të gjitha anët.

Ora mbërrijti pesëshin. Unë zgjova Artin, **i cili** përnjëherë brofi në këmbë, **i** gatshëm për të marshuar drejt shpëtimit. Mundohej t'a luftonte gjumin që ende nuk e lëshonte. Sa me saktësi përcillte çdo lëvizje të muskujve në fytyrën time, ngjyrën e shikimit tim. Me të gjitha këto gjeste mundohesha të shprehja vetëm optimizëm, shpëtim. Kjo **i** nevojitej Artit!

Ndoshta, ky është momenti vendimtar në jetën e tij. Nga kjo gjë akumulonte forcë. U nisëm. Po shpresojmë me fat. Ecnim, ecnim, dhe herë pas herë shikonim orën. Më mirë mos t'a shikojmë fare. Ndoshta kështu do të arrijmë më shpejtë.

- Nanë, shikoje çfarë lule e bukur paska çelë! klithi i gëzuar Arti.

- A bën t'a këpus? - vazhdoi me një ton lutës. U ndala. Me gishta të vegjël e të njomë kapi lulen shumë kujdesshëm e me ngrohtësi, e ngriti ngadale për t'i marë erë. E mbante kujdesshëm
dhe e shikonte me shumë ëndje.

- Nanë, ku po shkojmë? A po shkojmë te ato lulet? – prapë më pyeste Arti, për t'a marë përgjigjën time, e cila i pëlqente shumë, e që dukshëm vërehej dyshimi i tij. Unë ia vërtetova përgjegjen, duke ia zbukuruar lulet me fjalë dhe duke ia përshkruar ngjyrat e tyre të llojllojshme. I përshkruaja, e njëkohësisllt, edhe vet mundohesha të jetoj në atë pamje. Edhe

pse flisja me vështirësi e pa disponim, thellë në mua shkëlqente fija e shpresës dhe e sigurisë se me të vërtetë do të arrijmë te një tokë me lule qetësie e sigurie.

Shpresë më të madhe kishin njerëzit në krye të kolonës. Ishin më të shëndetshëm, me anëtarë të familjes të fortë për të ecur. Sa më mbrapa kalonës, edhe shpresat për të arritur në të sigurtë ishin më të vogla. Unë mundohesha t'a mbaja mesin e kolonës. Tani për tani, lehtësi të madhe kisha qëndrimin dhe të ecurit e Artit. Nuk dihej cili terhiqnim tjetrin, unë Artin, apo Arti mua.

- Shtrëngoma dorën, - më thoshte, nëse ndonëjeherë, nga lodhja e liroja ndopak. Këtë gjë nuk e kërkonte rastësisht, dhe jo vetëm sot. Shtrëngimin e dorës së tij e kisha bërë shprehi kohë më parë, qysh se kisha filluar t'a shetis apo të kryej blerje nëpër rrugët e qytetit tonë. Shikime të shtangura, nga urrejtja, shpesh hasnim. Natyrisht, shikime të sërbeve.

Quditshëm, hutueshëm, si të dehur, më shumë shikonin Artin. Ata e dinin pse. E, unë nga frika për te, e kisha bërë shprehi t'ia shtrëngoja dorën, t'a ruaj, t'a rris pa brenga e pa trauma. Ashtu i duhet vetës, ashtu më duhet mua, ashtu i duhet tokës Dardane gjenerata e re. Për gjendjen e tanishme, Arti do të kuptojë me vonë, nëse është e mundur t'a shtyejmë këtë për më vonë. Tani për tani kërkonte vetëm t'ia shtrëngoja dorën… Arti im... Me shtrëngimin e dorës së vogël më dukej ia shtoja sigurinë dhe e mbroja nga ato rrethana rrënqethëse. Edhe në këto momente po e shtrëngoj të njejtën dorë, por tani që t'a largojë nga rreziqet dhe t'a shpie të shëndoshë në ndonjë vend të sigurtë. Këtë ia kam borxh në rolin e prindit, madje edhe nëse kjo mundësi është tepër e vogël – këtë detyrë më duhet t'a kryej…

- Ç'na banë! Ç'na banë! - Nga çdo anë degjo- heshin këto fjalë. Shumica e

pleqve mezi zvarrisnin këmbët nga lodhja. Ata, më vonë, të sëmurë i
bartnin të afëtmit e tyre me karroca të ndryshme. Fshanin thellë. Fëmijët shumë shpesh qanin. Njerëzit, shpesh pështynin dhe shanin me mllef.

Kishim kujdes që të mos e devijojmë vijën që ishte tërhequr përmes asfaltit, për të treguar drejtimin kah duhet të ecë kolona e njerëzve; Njerëzit që pa kurrfarë pyetjeje dhe kushti duhet t'i lëshojnë trojet e veta etnike. Zemra e këtyre njerëzve nuk di të merr frymë si duhet në tjetër vend. Por, vallë, kjo vijë a është e sigurt për ne?...
Vende, vende, në kolonë pashë disa njerëz të vërenjtur në fytyrë. U ulëm të pushojmë pak, ndërsa 10-12 vetë u larguan. Më vonë kuptova se, ashtu siç u lejuan mundesitë, varrosën një njeri të moshuar, që kishte vdekur nga lodhja dhe ethet që e kishim kapluar.
Arti, tani kishte mbushur grushtin plot me lule. Disa kishin filluar të vyshken. M'i

zgjati mua, duke thënë se i kishte mbledhur për mua. E përgëzova, e urova, i mora lulet dhe i futa në çantë. Ishte e pamundur t'i mbaja në dorë. Arti i shikoi dhimbshëm. Edhe ai e dinte se nuk kishim si t'i bartnim ndryshe. Vetëm heshtëte. Edhe ai, zemërimin e vet mundohej t'a fshehte nga unë. Kishte shumë dëshirë të më shihte të disponuar.

- Shtrengoma dorën! - i përsëriste shpeshherë këto fjalë, që në vete përmbanin një histori të tërë, e unë, aspak nuk kisha dëshirë t'i dëgjoja. Më dhimbsej dhe, me gjithë forcën, i largoja këto mendime.
Futa dorën ne çante dhe nxora nje gurabi që e kisha ruajtur për Artin. E mori, më tepër për të ma bërë mua qejfin. Nxora edhe një bombone dhe ia futa shokut të tij Gëzimit në gojë. Me vete kisha disa qese me bonbone dhe një çokollatë. Unë ushqim, gjatë tërë ditës, kisha 2-3

bombone dhe ujë, aq sa gjindej tek të afërmit e mi. Për Artin, ujin e siguronin të gjithë. Ditën e sotme ende nuk kishim hasur në ujë të pijshëm. Kishim shumë nevojë për te, pasi që hargjoheshin edhe rezervat e fundit.
Vërejta se Artit nuk i pëlqente gurabia. Ia mora me kujdes, e mbështolla, kurse në gojë ia futa një bombone që e pranoi me kënaqësi. Pak pushim…

10.

Kalona u nis. Pushim tejet i shkurtër, sidomos për pleq dhe fëmijë. Vazhduam kështu nëpër rrugën e djegur të Drenicës, ku shpesh thyeja heshtjen me zë të ultë për disponim të Artit, me këngë tashmë të njohura nga bashkëudhëtarët rreth meje.
Përnjeherë mbi ne u formuan re të zeza, të cilat pa fije mëshire filluan të lëshojnë shi të madh, shoqëruar me stuhi të ftohtë. Tani për tani nuk kishim ku të ndalemi. Para nesh shtrihej asfalti, që të mbushej mendja se askund nuk ka fund. Në anën

e djatht, fushë e gjerë. Edhe ne anën e majt lëndina të pafundme, që në këto çaste, për ne ishin neveritëse.

Vazhdonim te ecnim nëpër shi të madh. Ecnim pa destinacion. Artin e tërhiqja për dore dhe pa e shikuar fare ndjeja se si arrinte shiu nëpër tërë lëkurën e tij të njomë. Shiu nuk ndalej. Kalona ecte. Qielli qante. U lodhëm shumë, më tepër ne të fundit, nga përpjekjet që të mos shkëputemi nga kolona. Kishim përvojë të hidhur nga shkëputja në Përroin e Keq të Drenicës. Edhe më tej të dy anët tona shtriheshin fusha të gjëra, e përpara asfalti i pafund. Akoma asgjë, asnjë vend për t'u strehuar.

Edhe pse mjaft larg, në dukje u paraqit një barakë e vjetër. Na u duk se na erdhi dikah njefarë force për të arritur sa më shpejt, që të mbrohemi, sadopak, nga shiu.

Fillimi i kolonës arriti dhe menjëherë në oxhakun i barakës u duk tymi. Kishin

ndezur zjar për t'i tharë sadopak rrobat dhe për t'u ngrohur pak. A do të arrijë edhe unë t'a ngrohë dhe t'ia ndërroj bile çorapet Artit? Me vete kisha pak ndërresa për te. Shumicën i kishim lëshuar rrugës nga lodhja, ndërsa këto që i kisha i bartëte Edini, së bashku me batanien, edhe pse e kishte një valixhe të vetën mjaft të rëndë.

Po i afrohesha asaj barake dhe përnjeherë pyeta veten: a do të arrijë ndonjëhere në te? Artin e mora, t'a bart, bile për pak çaste. A është e mundur që të më rrjedhin lotët përkundër dëshirës sime?! Po, po rrjedhin. Po vërej se po na lëshon fuqia, si mua ashtu edhe Artin. Arti tani dridhej me të madhe.

Më në fund, arrijtëm të hyjmë në atë barakë. Nga tollovia, mezi depërtova në hyrje të saj. Me shpejtësi e zhvesha Artin, t'ia ndërroj rrobat. Mora nga Edini ato pak që kisha të thata dhe duke ia veshur, kolona përgatitej te nisej.

Ende binte shi. A do të mundemi të qëndrojmë. Mezi mblodhëm forcë të përgatitemi dhe të nisemi. Shpresat për t'u larguar nga kjo zonë e rrezikshme zvogëloheshin me të madhe.

Vazhdonim të ecnim nëpër erë me shi. Përnjeherë, Arti filloi prap të qante me atë vajin rrënqethës dhe mjaft të ndjeshëm. Vajtonte për shtëpi, për ngrohtësi familjare, me biseda të përzemërta. A thua a i ka pasur ndonjëherë ashtu si e meriton një fëmije, një qenie e pafajshme. Jo. Deri në këto çaste, kurrë nuk e ka ndjerë ngrohtësinë familjare, ngapasojat e robërisë që na kishte arritur në palcën e ashtit. Robëri, që për asnjë moment nuk na lente të qetë, reflektohej nga çdo anë. Kishte arritë kulminacioni. Jemi popull që e urrejmë luftën, e duam paqen. Shumë paqe për popullin e vet dëshiroi Ibrahim Rugova; për paqe dha jetë Ahmet Krasniqi…Ademi me familje – fis i tërë… Nga të gjitha altenativat e mundshme do t'a zgjidhnim paqen, por me te vëretetë,

ishte koha për luftë, sinjalet e së cilës i dha UÇK-ja ne krye me legjendarët Adem e Hamëz Jasharin, Agim Ramadanin; Mujë Krasniqin, Abedin Rexhen, Fehmi Lladrofcin, Xhevë Krasniqin-Lladrofcin , Bekim Berishen, Adrian Krasniqin, Rasim Kiçinen, Ali Krasniqin, Beqir Gashin... dhe me paraardhësit e tyre: ..., vellezerit Gërvalla, Kadri Zeken...

Pa marrë parasysh pasojat, edhe në këto momente, në thellësi te trurit , jam më e qetë sesa më parë.

Arkivi I Kosovës
Kosova 1999
Foto nga Paul
Refsdai_Gazetar Norvegjez

- Nanë ku po shkojmë? A kemi shtëpi? - vazhdonte të më bombardonte Arti me

ato pyetje që tani as vet nuk kisha force të mendoja për ndonjë përgjegjie sadopak të arsyeshme dhe qetësuese. Këtë gjë shumë mirë e kuptonte edhe Arti, i cili ma bënte qejfin, duke u perpjekur që të qetësohet me disa përgjegje shumë të shkurta dhe të thjeshta.

Shiu pushoi. Aty-këtu ndonjë rreze dielli reflektohej në asfaltin e lagur, që së bashku me erën jepnin shpresë se së shpejti do të na thahën rrobat në trup. U afrua Visari, tezaku i Artit tetëmbëdhjetëvjeçar, i shëndoshë dhe fizikisht mjaft i fortë. Përkëdheli Artin dhe m'u drejtua, duke u ankuar se sa shumë ishte lodhur; sa me vështirësi po i tërhiqte këmbët nga lodhja. Mirëpo, shtoi Visari, kur po i kujtohet Arti se si po qëndron, po i shkon mendja me i ra kokës për asfalti, nga turpi. Buzëqesha dhe ia ktheva si me tallje -

E ka nana djal sokol,
E ka nana djal petrit,
E ka nana djal shkollarë,
E ka nana hokatar…

Trim për pushkë e t'mirë për fjalë, Është i parë, bajraktar,
Ky eshte Arti, mbret shqiptar!

Ndërsa, Visari i çuditur sesi mund të gjeja forcë edhe tani, në këto momente të vështira, për fjalë përkëdhelëse, vazhdoi me hapa më të shpejtë, duke lëkundur kokën majtas e djathtas dhe duke tundur dorën që të pushoja, kurse mua, më shpërtheu gazi. Isha e vetëdishme se edhe Visari kishte nevojë për, së paku, ndonjë fjalë gazmore, e që zuri Enisin, i cili qëndronte përkundër faktit se pak javë më parë kishte kryer operacion të rëndë.

E unë me zë të ultë, për përkrahje morale Artit, vazhdoja të thyeja ritmet e hapave të rreth 2,500 njerëzve në kolonën e udhës së djegur. E djegur shumë herë në këta shekuj e mileniume... Deri kur më të na përsëritët kjo histori e trishtë... Vazhdoja pa menduar shumë…

O bilbil Kosova, hije të paska shkolla,

Ti moj Kosovare, sot ti je krenare…,

Sa çudi! Përkundër të gjitha rrethanave, jeta vazhdon me të gjitha ngjyrat e veta. Diku gaz, diku lot, diku biseda të përzemërta e harmonike, diku simpati, e diku xhelozi... Të gjitha këto gjëra po ndodhin në kolonën tonë. Jeta, në të vërtete, po vazhdojka me të gjitha ndodhitë e veta, madje, edhe në rrethanat që jemi tani.

Në çdo udhëkryq ndalesë policie. Na drejtonin kah dëshironin. Zgjidhnin relacione sa më të gjata që ishte e mundshme. Me plot peripeti arritëm në Gurrakoc. Edhe 25 km do të arrijmë në Pejë. Pastaj, do të vazhdojmë kah Rozhaja dhe kështu, për më tej, të gjejmë ndonjë transport me më pak rrezik. Shpresojmë të arrijmë në Ulqin, pasi që për të vazhduar kah Shqiperia nuk kishim force. Transporti mungonte; pleqtë vdisnin rrugës, fëmijët sëmureshin. Ata pak ushqim që kishim ishte harxhuar. Thjeshtë - kolona ishte rraskapitur.

Binte muzgu. Forca të mëdha sërbe ishin përqëndruar në këtë qytezë. Duhet të shpejtojmë që ta kalojmë qendrën e qytetit. Nga çdo anë grumbuj forcash të armatosura, nga të cilat në çdo moment pritej rreziku, sidomos për të rriturit, për burrat dhe vajzat.
Në dalje të qytezës së Gurrakocit, policia na ndali në një udhëkryq për rreth 10 minuta. Na drejtuan ne drejtim te Klinës, që të vazhdonim për në kufirin Kosovë-Shqipëri. Vazhduam si të dehur, edhe pse shumë të dyshimtë se do të n'a lejojnë të arrijmë.

11.

Errësohej gjithnjë e më tepër. Shtëpi të braktisura kudo. Vendosëm t'a kalojmë natën në to. Në shkallët e një shtëpie u ula të pushoj pak me Artin. Mbështeti kokën në krahërorin tim, volli dhe mbylli sytë. Menjëherë e thirra Dr. Sanijën, tezen e Artit dhe e pyeta mos është diçka

serioze. Ajo, disi e hutuar, më këshilloi të mos merakosem shumë pasi që fëmija ishte lodhur shumë dhe kur të pushojë, do t'i kalojë.

Arkivi I Kosovës/ Kosova 1999/ Foto nga Paul Refsdai_Gazetar Norvegjez

Nga lodhja mezi u vendosa në një skutë të një dhome të zhveshur nga plaçkitjet. T ani ishte errësuar thuaja krejtësisht. Artit, menjëherë ia zhvesha pantollonat ende të lagëta dhe e mbështolla me batanie. Kjo natë kaloi pothuajse pa pushim, pasi që Artit çdo minut i keqësohej gjendja. Tërë natën kërkonte ujë, të cilin pa e gëlltitur mirë, e villte. Kah mëngjesi i mbyllëm pak sytë. Në të vërtetë unë i

mbylla, sepse Arti gjithmone i mbante mbyllur. Kjo kotje nuk zgjati shumë, pasi që filloi të agonte dita e re. Nuk e dinim se çka do të ndodhte.

Posa zbardhi dita, shpejt e shpejt, u zgjuan pothuajse të gjitha gratë. Pasi që rrymë nuk kishte, natën nuk kishin pasë mundësi të punonin asgjë. Ndezën zjarin, gjetën miellin e shtëpisë dhe filluan të gatuajnë bukë. Mezi mblodha veten. Poshtë, Arti flente me sy gjysmë të mbyllur dhe ishte zbehur së tepërmi. Duhej të përgatitëm edhe unë, pa menduar fare se a mund të qendrojë apo jo. Mbi shporetin e ndezur vendosa rrobat e Artit për t'i ngrohë pak. Lart, mbi kokë, pashë shumë ikona dhe figura kishtare. Përballë gjendej një fotografi e madhe me nje grua në të bardha, e njohur për të gjithë ne. Nëna Terezë e pavdekshme. Ndoshta shpirti i saj po na vëren në këto çaste të vështira, e lutjet e saj do të na shpëtojnë. Amin!

Krahas saj, busti i Skënderbeut, i gdhendur në gurë. Jo, jo! Askush nuk ka me e shue këtë familje shqiptare atdhedashëse. Do të kthehën në vatrat e tyre dhe t'a vazhdojnë jetën në qetësi e pa frigë.

Pas pak në krahëror ndjeva dorën e tezes së Artit, Shemës, që aq shumë e donte dhe më afroi dy kuleq. I kishte gatue shpejt e shpejt, për t'ua liruar shporetin grave të tjera. Më tha se ishin për mua dhe Artin. I mora e prekur nga shqetësimi i saj për Artin. As kjo nuk kishte fjetë fare, pasi që kishte qenë ne anën tjetër të Artit. Sytë i ishin enjtur duke qarë.

- Përgatituni, përgatituni! Nisemi! - degjoheshin zëra, për t'u përsëritur shumë herë.

E zgjova Artin. E dija mirë se në çfarë gjendjeje ishte. Ai, me vështirësi ngriti kokën, m'u mbeshtet në krahëror, shumë i molisur e me buzë të thara nga temperatura, me zë të ulët m'u drejtua:

- Nanë, nisu ti, shko, unë po rri këtu!!!

…Shqetësim!!!…

- Nuk të le nana ty kurrë, djali im, mos u bë merak! Shih sa mirë po dukesh! Do të qendrojmë,

- ia ktheva menjëherë duke u mundue me buzeqeshë e, në të vërtetë, mezi e përmbaja vajin. Kisha dëshire me qenë diku larg tij, vetëm me qajtë, por para Artit nuk mund t'ia lejoja vetes një gjë të tillë. Duhet t'a mbroj dhe t'a forcoj moralisht, aq sa është e mundur, deri në momentet e fundit. Duhet të ketë mbështetje diku momentalisht. Mbështetja e tij e vetme isha unë. Mua më ndihmonin shumë familjarët e mi.

Nuk guxova të dorëzohem për asnjë moment, që të mos dorëzohet as Arti. Së paku, kështu mendoja, sepse Arti e vlerësonte situatën shumë mirë.

E dija mirë që Arti nuk do të mund të vazhdonte të ecte. As unë nuk isha në gjendje që t'a bartja. Shpresoja se do t'a gjeja ndonjë zgjidhje. Ngadale, ktheva kokën dhe vërejta se tërë këtë skenë e

përcillnin tezet e Artit, Sanija dhe Shema, të cilat nuk mund t'i permbanin lotët. I pyeta çfar të bëja. Nëpër mendje më silleshin dy mini-traktorë të mbingarkuar me gra të sëmura dhe me fëmijë e mitur. Ndoshta vlenë të provoj ta pyes pronarin e tyre të më ndihmojë në këtë moment të vështirë. Në njërin gjendej një grua që kisha bërë pak bisedë me të, në fshatin Shipol, para se të nisemi, por tani a thua, a do të mund të më ndihmoj.

- Provo, shpejt provo! - m'u drejtua Dr. Sania.

Shpejt mbështolla Artin dhe fillova t'a kërkoj gruan nga minitraktorët. Kuptova se minitraktorët ishin nisë.

- U nisa me i zanë! - iu thash të afërmve të mi dhe fillova të vrapoj me Artin në krahëror. Në fillim vrapova, por shpejt me lëshoi fuqia. Në atë çast ndjeva zhurmën e traktorëve dhe syri ma zuri njërin sish. Mora forcë dhe eca me hapa të shpejtuar.

- O pritni pak, më ngadale, ju lutem! Më falni! Tani zura traktorin dhe pushova së foluri, pasi që kisha mbetur pa frymë nga lodhja. Përnjeherë, më shkrepi shpresa se nuk mund të më refuzojnë. Por, kush e di, një minitraktor njëherë më pat refuzuar. T'a lus tani këtë grua që, sadopak, e njihja. Mezi flisja, duke bërë lutje.

- Jam e sëmure, tha gruaja që kishte pasur tri operacione për tre muaj, - por, nëse është nevoja, tërë kohën do të eci që t'ia liroj vendin ketij vocë- rraku. Tani për tani, do të zbret bija ime. Me shpejtësi zbriti e bija e saj, një vajzë shumë e bukur dhe shumë e matur. E quanin Njomëz.

Uh! Ç'lehtësim! Menjëherë ula Artin në një skaj, me ç'rast dukshëm u vërejt kënaqësia e tij për këtë gjë. A thua, do të qëndrojë ky traktor I vogël me gjithë këtë peshë. Të dukej se në çdo moment do t'i pelcitnin gomat. Bartëte një numër të madh njerëzish, natyrisht gra dhe fëmijë.

Menjëherë, u afrua udhëheqesi i familjes, që ishte nga fshati Lushtë. Pyeti për vendosjen e fëmiut dhe pas kuptimit të gjendjës, menjeherë u largua, pak a shumë i kënaqur, që kishin pasë mundësi me më ndihmue. Unë, ecja krahas traktorit dhe çuditesha me vete sa e çlodhur ndihesha.

Për një momenti mini-traktori rriti shpejtësinë, me ç'rast unë ndalova hapin, duke qenë e kënaqur që Arti ishte në traktor dhe mund të vazhdojë. Në ato momente më arriti gjyshja e Artit, nana ime Miradia. E trishtuar më urdhëroi që të mos ndahem nga Arti. Ashtu ishte. Traktorëve nuk iu dihej kah shkonin. Moment hutimi, që për një çast do të mund t'a kisha humbë lidhjen me Artin!!! Më tej nuk do të na dihej fati i asnjërit!

Vazhdova edhe për një kohë krahas mini-traktorit dhe duke morë Artin për të vazhduar me të afërmit e mi, gruaja fisnike në traktor, më bëri me dije se mund të ngushtoheshin pak, që të më bënte vend

edhe mua. U vendosëm me mirënjohje e falenderime të mëdha…
Udhëtuam kështu rreth katër orë. Tek çdonjëri prej nesh, mjaft qartë, vërehej lodhja dhe uria. Edhe 15 km dhe do të arrijmë në Klinë. Flitej se ekziston rreziku, që forcat sërbe të mos na lejojnë të kalojmë, duke na kthyer në rrugën tjetër, kthyese, drejt Skenderajit. Këtë fat kishin pasë disa kolona para nesh. Arritëm tek një godinë e bardhë madhështore.
Dukej se i ka hapë krahët që të n'a bëjë konak të gjithëve. lshte kisha shqipëtare në Zllakuqan. Pak me larg saj ishin vargisur forca sërbe, të cilat nuk na lejonin të kalonim.

Kisha në Zllakuqan (Nga Mediat)

Fuqia na kishte lëshue plotësisht. Na kishte kapluar uri dhe etje e madhe. Dëgjuam se prifti na ftonte të hyjmë në oborrin e kishës. Dukej oborr i vogël por na zuri të gjithëve. Aty, para neve kishte arritë një kolonë e madhe që ishte nisë para nesh. Me të arritur në Klinë, forcat sërbe e kishin detyruar të kthehet prapa. Grupe-grupe u ulëm në barin e njomë. Nga dhembja e shputave të këmbëve, filluam t'i zbathim të mbathurat me kujdes. Nuk e dija a do të jemi në gjendje të vazhdojmë

me tej. Afër dëgjohej shushurima e lumit, ku si të plagosur, një nga një futnim këmbët në ujin e ftohtë, që rridhte këtë ditë pranvere të 19 prillit 1999. Ashtu i mbanim për një kohë, që sadopak të n'a kalonte temperatura dhe dhembja e shputave të këmbëve. Efekti ishte i dukshëm…

Artin e shtriva mbi shtrojën që e vendosa për të. Më shikoi ëmbël dhe fjeti menjëherë. Ia lirova këmbët nga këpucët dhe çorapet, me ç'rast, me dhembje, vërejta lëkuren e shputave të tij, vende-vende të ngritur nga kallot.

Prifti dhe motrat e nderit na lajmëruan se së shpejti do të arrijë ushqimi për ne. Nuk kaloi as një çerek ore dhe 4-5 traktorë të mbingarkuar me ushqim hynë në oborrin e kishës. Banorët që ende gjindeshin në fshatrat përreth, të njoftuar se po kalonin kolona njerëzish të lodhur e të uritur, kishin organizuar përgatitje ushqimi për ne.

Ushqim të mjaftueshëm kishte për tërë kolonën: bukë pogaçe të këtyre anëve që kishte shije dhe aromë më të mirë se çdo lloj buke në botë, djath të freskët, qumësht të vluar, zarzavate që të mbushej mendja se po atë moment janë këputur nga bahqja, vezë te ziera, pite të gatuara me kujdes... Begati e madhe i shtohej këtij ushqimi, aq i rëndesishem dhe i duhur per ne, me mënyrën fisnike të shpërndarjes së tij. Burra e djem shqiptarë, me ndjenja e fjalë na e qetësonin shpirtin dhe përnjeherë na e ngritnin krenarinë. Mënyra e gostitjes me ushqim dallonte dhe kishte një ego që nuk gjendet askund, e veçantë, e lindur, e trashëguar brez pas brezi. Fytyra e qartë e mikpritjes shqiptare u paraqit para të gjithë neve. Sa mirë është ruajtë në këto treva kosovare. Është ruajtur me shekuj, përkundër vuajtjeve nga robërimi i sundimtarëve te ndryshëm...

Pushuam relativisht mirë, por nuk guxonim të sillnim nëpër mend se së shpejti duhet të

ngrihemi dhe t'ia mbathim dikah. Në një anë të oborrit dukeshin disa kamionë. Shpejt kuptuam se ishin plot municion që forcat okupuese i kishin vendosur aty. Qartë vërehej se disa policë sërbe përgatiteshin për të na nisur dikah. Kështu, pas rreth katër orë qëndrimi në këtë oborr, tamam si vend historik për ne, u detyruam të ngrihemi dhe të vazhdojmë kah të n'a drejtojnë. Zgjova Artin, i cili tërë kohën mbante sytë mbyllur, e përgatita për rrugë dhe nxitova me të shpejtë që t'a arrijë minitraktorin. Nga tollovia mezi e arrita. Nga pas gjithmonë përcillja me sy familjarët e mi, që gjithsej në numër ishim 17.

N'a urdhëruan të kthehemi mbrapa. N'a than se duhet t'a kalojme pasditën dhe natën e sotme tek disa shtëpi të braktisura nga banorët e tyre disa ditë me pare. Ato shtëpi gindeshin rreth pesë kilometra larg nga këtu. Për më tej do të informoheshim më vonë.

U nisëm, kah kishim ardhë. A thua, ku po na çojnë. Më nuk bënim aq shumë

pyetje. Vetëm ecnim. As Arti nuk bënte pyetje si më parë. Tani më shumë ishte i preokupuar me vendin e tij në traktor. Në sytë e tij vërehej frika se mos mbetej prap të ecte këmbë. E dinte se nuk do të mund të qëndronte. Pas rreth një orë e gjysmë kthimi, prap u ndalëm. Me të shtëna nga armët, nga një punkt që e hasëm, n'a drejtuan në një rrugë tërthorazi më këtë kryesoren. Asgjë nuk dukej, përpos gjelbërimit pranveror, bukurinë e të cilit ishte e pamundur t'a shijojmë, në këtë gjendje që ishim. Duke ecur, kaluam mbi një urë të një lumi. Dikush tha se quhej 'Ori i Bardhe', që nuk ja vura shumë veshin. Diktuam se në mes të atij gjelbërimi ishte një fshat i braktisur. U afruam dhe u shpërndamë nëpër oborre të atyre shtëpive, duke nxituar, nga frika se mos mbeteshim natën jashtë kulmeve të tyre. Mora Artin para duarve duke i prcjellë të afërmit e mi, që të mos mbetem larg tyre. Ata u strehuan në një ndër shtëpitë e para të fshatit. lshte nje kullë e vjetër me një

oborr të gjerë, ku çdo skutë e tij kishte një histori në vete. Në mes të oborrit gjendej pompa e ujit, ku u freskuam. Afër saj shumë kazanë madhësish të ndryshme ishin renditur me kujdes dhe menjëherë kuptuam se ishte shtëpia me nje familje shumë-anëtarëshe me tradita, zakone e pastërti shqiptare.

Për kohë të shkurtër qëndruam në oborr, pasi që brenda ishin zënë të gjitha dhomat. Bisedonin se si të na e siguronin edhe neve një vend. Bashkë me ne, në atë shtëpi u vendosën 87 vetë.

Arti më dukej më i kthjellët. Ia tërhiqnin vëmendjen dy qentë e shtëpisë, të cilët silleshin rreth nesh të gëzuar, duke u shtrirë në pozita të ndryshme dhe duke lozur pa pushim. Lëshonin zëra që edhe pa dashje, me çdo kusht na e tërhiqnin vëmendjen. Me gjestet e tyre na bënin me dije se ç'kishin përjetuar banorët e këtij fshati, së bashku me ta. Në oborr u mblodhën edhe lopët e shtëpisë dhe nuk largoheshin dot. Nga shikimi i tyre

kuptohej çdo gjë. Të trembura, nuk na largoheshin. Qartë vërehej përhumbja e tyre. Artit, këto shtazë ia tërhiqnin vëmendjen shumë, por më së shumti i donte zogjtë e vegjël të pulave që sa kishin dalë nga vezët. Nuk ua ndante sytë. Knaqej duke e shikuar se si i ushqente tezaku i tij Edini me miell misri, të cilin e kishte kërkuar dhe gjetur në kuzhinën e shtëpisë.

Gratë me fëmijë të vegjël menjëherë iu përveshën punës për pastrimin e tyre si dhe të mjedisit ku gjendeshim. Vërehej një gjallëri shtëpiake. Mblodha veten dhe u mendova se çka duhet të bëj. Por, a thua premton koha? Natën e parë e dija se do ta kalonim këtu, por ç'do të na sillte dita e nesërme. Më mirë të mos mendoj, por edhe unë t'i përvishëm punës. Një grua na ftoi që të hyjmë brenda. Na njoftoi që për ne femrat dhe fëmijët, që kishim mbetur në oborr, kishin siguruar një dhomë. Burrat do të shkonin në odën e shtëpisë, e cila gjendej në katin e tretë.

Kjo odë i kishte mahnitur të gjithë, me stilin e saj autokton, me ndërtimin dhe meremetimin karakteristik.

Kulla_Strehimi në Zabllaq (Enver Shala dhe Faik Shala – pjesëtarë në kolonë)
_Foto të shkrepura nga Shpresa-Shala–pjesëtare-në-kolonë

Shpejt e shpejt e pastrova Artin me ujin që e nxeva mbi shporetin e ndezur në shupën e shtëpisë, sepse ai në kuzhinë ishte shumë i zënë nga gratë tjera. E dija se ishte shumë i lodhur. E ushqeva me pak bukë që kisha marë me vete nga oborri i kishës dhe e dërgova në dhomë për ta vënë në gjumë. Ishte një dhomë e vogël kulle, me dy dritare të vogla, një 'hamamxhik' në njërin skaj, dy shtretër, dy

arka të mëdha druri me shumë rroba, që kryesisht ishin veshje kombëtare shqiptare. Menjëherë të binin në sy rreth njëzet shami të bukura nga pambuku, të punuara me dorë në vek dhe të palosura me kujdes të madh. Kush thot se mendafshi kinez apo kasha angleze janë të çmuara? Sigurisht, ata nuk e kanë parë këtë punë dore, të trashëguar shekuj me radhë. Kulturë e jona. Por, tani nuk kishim kohë të mendonim për këto gjëra. Në pyetje ishte diç tjetër – mbijetesa ...

Në njërin nga shtretërit vendosa Artin. Katërmbëdhjetë vetë do të flenin në këtë dhomë tri metra me tri. Na dukej parajsë. Në dysheme shtru- am kashtë, meqë ajo dhomë ishte pa dërrasa, sepse dy shtretër ishin pak për të fjetur 14 vetë.

Të nesërmen, si çdo ditë udhëtimi, të gjithë mundoheshim të gjenim ushqim për rrugë. Pritnim të na drejtonin dikah. Pritëm, kështu tërë ditën. Kurrfarë shenje për rrugë. Si t'ia bejmë? A guxo- jmë të misemi? Kah të nisemi? Të gjithë vetëm

heshtnim. Ishim mjaft të shqetësuar nga pritja dhe nga frika. Kolona, e bashkuar me të tjerët në oborrin e kishës, kish rritë numrin në mbi tremijë vetë. Ishim futur në këtë fshat të vogël, që as emrin nuk ia dinim, të braktisur nga banorët e tij disa ditë më pare, dhe të granatuar nga forcat sërbe. Na shkonte mendja gjithanej dhe shqetësoheshim edhe më shumë duke dëgjuar lajmet e radio DW-së, nga një tranzistor i vogël. Çdo ditë vrasje e masakrime të popullsisë së pafajshme shqiptare, çnderime të ndryshme, ndarje familjare ... Ç'do të bëhet me ne? Silleshim si të mpirë…

Rreth mesditës arritën traktorët e ngarkuar me ushqim nga banorët e fshatrave përreth, që kishin vazhduar ta organizojnë përgatitjen e ushqimit. U printe prifti i kishes së Zllakuqanit. Na lehtësuan shumë, si me ushqim, ashtu edhe moralisht. E dinim se kemi një farë lidhjeje me botën. Më të

relaksuar, vazhduam të qëndrojmë në këtë fashat.
Ky furnizim me ushqim zgjati pesë ditë me radhë. Ditën e gjashtë forcat serbe e kishin ndalue, me ç'rast e kishin maltretuar dhe rrahur rëndë priftin.

12.

Të lodhur e të hutuar nuk dinim si t'ia bëjmë. Duhet t'i shfrytëzojmë sa më racionalisht gjërat ushqimore që i gjetëm në këtë fshat. Në masë më të madhe kishte patate, grurë e misër. Nuk mungonte as kripa. Qepët dhe hudhrat e mbjellura, të cilat ende nuk ishin rritur sa duhet, ashtu të njoma filluam t'i nxjerrim. Mbledhnim hithra dhe gjethe të luleve nane, i zienim dhe i pinim si çaj. Pra, ishte fshat mjaft i begatshëm, që unë ende nuk dija se si quhej, deri sa një ditë nga fshati fqi ishin përvjedhur dhe kishin ardhur t'i vizitojnë shtëpitë disa pronarë të tyre.

Fshati quhej Zabllaq. I përkiste komunës së Istogut. Ne gjindeshim në shtëpinë e Ahmetajve. Pronarët filluan ta vizitojnë shtëpinë çdo ditë, në menyrë mjaft të fshehtë. Pos kullës kishin edhe katër shtëpi identike, të posandërtuara dhe të meremetuara, dy të qëlluara me granata. Edhe ata, sa u lejonte mundësia, merrnin gjëra ushqimore dhe shikonin shtazët shtëpiake.

Fshati Zabllaq (Nga mediat)

Ndjeja nevojë për pak qumësht lope për Artin, pasi që tani banorët e fshatrave përreth nuk kishin mundësi të na sillnin. Përkundër dy lopëve që gjindeshin në atë shtëpi, nuk arrija ta siguroj asnjë pikë qumësht, pasi që kishte tollovi dhe

përlamje të madhe rreth tij. Një grua me dy bijtë e vet nuk lejonte që askush të afrohej tek lopët, me arsye se vetëm ata po kujdeseshin për to. Ua shpërndanin të afërmëve te vet, e për më tepër thoshin se nuk mbetej. Heshturazi, zhvillohej një luftë e ashpër për ekzistencë. Mezi përballohej.

Në fillim e kishim më vështirë. Së shpejti u adaptuam që të ushqehemi vetëm me patate të pjekura dhe me misër të zier. Ne të rriturit e përballonim më lehtë, por fëmijët dhe pleqtë më vështirë. Shumica e fëmijëve u sëmurën nga barkqitja, e ndër ta edhe Arti. U dobësua shumë. Barna nuk kisha më, as ushqim dietal. Dr. Sania dhe Dr. Shaqiri kërkoheshin në çdo moment për t'u dhënë ndihmë njerëzve të sëmurë. Shpesh gjendeshin njerëz që kishin bartur ndonjë bari medicional më të lehtë.

Keshtu, nga disa pacient kishin kërkuar pak barna edhe për Artin.

Hyrja në kullë – Zabllaq _ Dr. Sanija / me vllaun Enverin / Djalin Kujtimin / nipin Enisin

Për ushqim gjendja ishte shumë e vështirë. Miell më nuk kishte fare. Vështirë përballova vajin e Artit kur qante për një pjesë buke me xhem, që e kishte parë një fëmijë duke ngrënë. Nga dhembja dhe pikëllimi mora nje lugë çaji dhe kërkova nga shumë gra, ndoshta rastësisht u gjendet pak. Kot. Nuk gjeta. Arti mezi u pajtua.

Përnjëherë filluan të arrijnë disa gjëra ushqimore nga korridori i vetëm, nga fshati Terstenik. Edhe pse me çmime

mjaft të larta dhe në sasi të vogla, për të gjithë ishte një lehtësim i madh. Për Artin gjeta pak biskota. Edhe dr. Sania i solli tri vezë të ziera nga një mik i bashkëshortit te saj. Çdo ditë ia jepja nga një. Duke ia dhënë afroheshin dy vogëlushe, Arta dhe Brelina, te cilat, duke u lëpirë, me lakmi e shikonin Artin duke u përbi. Në këto rrethana isha e detyruar që të njejtën vezë ta ndaja ne tri vende. Gjyshja e tyre, nje grua mjaft e vjetër, me tri mbesat e veta, Artën katërvjeçare, Blerinën trivjeëare dhe lxhiranin diçka më të madhe, nga pamundesia për të ecur, ishte hipur në një traktor, per t'u takuar me vonë me prindërit e fëmijëve. Në ndërkohë, traktori kishte vazhduar në drejtim tjetër nga të afërmit e saj, kështu që, tani këto vogëlushe, me gjyshen e tyre, kishin mbetur në mëshirën e fatit dhe të njerëzve përreth. Shumë shpesh i merrja për dore këta fëmije, dhe së bashku me Artin mblidhnim lule, që me to u thurja kurora. Qeshnin me gëzim.

Pa pyetje, të frikësuar kalonim ditët në këtë fshat. Dalëngadalë ia zbulonim bukuritë e rralla, me begati të pafundme, me livadhe të rrafshta, thuase i ke hekurosur me hekur, të rrethuara me drunj shelgjesh, që jepnin shenjë për ujë të mjaftueshëm. Rretherreth dukeshin kodrat që ende, diku-diku, vërehej gjurma e borës. Ç'vend i mrekullueshëm. Këtë hijeshi do ta vërenim më mirë po të kishim kaluar këtupari të lirë, të qetë dhe të sigurtë. Kjo gjë tani për tani ishte aq larg nga ne, sa që as nuk guxonim të mendonim për të.

Për pak ditë filluam të adaptohemi në rrethin që gjendeshim. Më tepër se tetëdhjetë vetë në një shtëpi, me një pompë uji në mes të oborrit. U paj- tuam edhe me mungesën e gjërave elementare, por assesi nuk mund të pajtoheshim me faktin që të mos ktheheshim në vatrat tona. Edhe pse në këto rrethana, kthimi ishte i pamundur, prapëseprap, thellë në shpirt kishim shpresë për kthim.

Nga oborret e shtëpisë nuk guxonim të largoheshim. Menjëherë dëgjoheshin snajperistët, të cilët duke gjuajtur, trembnin çdo gjë të gjallë, e më së shumti fëmijët, të cilit aq shumë vuanin për bredhje të lira... Nëpër mendjen tonë sillej mendimi se po na mbajnë pengje lufte. Nga kjo gjë të gjithë frikësoheshim. Të gjithë me halle dhe preokupime të njejta. Tema e bisedës, në çdo mes ishte e njejtë.
Shpesh shpërthenin zënka pa nevojë. Ato, madje, shtoheshin dita me ditë, deri sa lodheshin nga to. Vërehej sesi hallet dhe nervoza tek njerezit, nxisnin mosmarrëveshje të mëdha, për disa imtësira që njeriu i qetë nuk do t'i vërente fare. Mirëpo, njeri të qetë në këtë mes nuk kishte...

13.

Gjashtë maji. Dita e Shën Gjergjit. Një ditë më parë, pak para mbrëmjes kishin filluar

gjuajtje të shpeshta nga snajperistët sërb. Kështu vazhduan tërë natën. Shpresonim se sot do të pushojnë, por me kot. Sa pushonin, prapë fillonin me intensitet të shtuar. Qëlluan një vajzë njëzetëvjeçare, e cila ishte duke nxjerrë patate nga gropa që gjendej pak përtej oborrit. Motra e saj që e shoqëronte mezi arriti të largohej. Pas rreth gjysmë ore, disa persona duke u zvarritur, arritën ta largojnë nga ara vajzën e plagosur. Mjekët që gjindeshin me ne, konstatuan se kishte gjakderdhje të brendshme. Gjasat për shpëtim ishin mjaft të vogla. E larguan disa pjesëtarë të UQK-së, të cilët shpesh gjenin menyra të na vizitonin.

Vazhduam të mbetemi në një gjendje pa siguri minimale. Nuk guxonim të merrnim lirisht ujë as në pompën e oborrit. Me vështirësi shumë të mëdha përgatitej pak sasi ushqimi, sa për ta shuar urinë që në këto momente e ndjenim shumë më pak. Dy lopët e shtëpisë, në arën më të afërt, kishin mbetur te plagosura. Ashtu të shtrira

dergjeshin, e britma e tyre të tmerronte. Edhe në këtë natë hymë me plot ethe. Tërë natën nuk pushuan gjuajtjet nga snajperistët dhe minahedhësit.

Agoi ditë e re. Me të gdhirë, të gjithë u mblo- dhëm në bodrumin e kullës trikatëshe, pasi që minahedhësit nuk pushonin së gjuajturi. Herë pas here dëgjohej edhe ndonjë granatë. Këtë ditë snajperistët vazhduan të gjuanin me intensitet edhe më të madh. Qëllonin çdo gjë që lëvizte. Vranë dy qentë e shtëpisë, të cilët na kishin bërë shoqëri tërë kohën. Nga pamundesia jonë per t'i ushqyer, për shkak të mungesës së ushqimit, të gjithë habiteshim se si hanin fije bari, sikur të ishin dele. Përreth tyre silleshin pulat me shumë zogj, që me kujdes ruheshin të mos i shkelnin. Tani, të shtrirë pa shpirt, i vështronim, na dhimbseshin, përkundër frigës se mos po na pret edhe neve i njejti fat. Snajperistët qëlluan në mes të oborrit edhe një pulë, e cila kujdesej për

zogjtë e saj. Çfarë krijesash mund të jenë që veprojnë në këtë menyrë? Për këto gjëra nuk kishim forcë të mendojmë, pasi që minat në çdo çast hidheshin afër e më afër nesh, derisa nuk filluan t'i godasin edhe shtëpitë me njerëz brenda.

Tërë ditën, të gjithë qëndruam në këtë bodrum. Mbi të gjitha mbizotëronin friga dhe britma e fëmijëve. Edhe në këto çaste mundohesha të gjejë rrugëdalje që t'ia largoj Artit vëmendjen nga këto krisma dhe nga kjo frikë, që e kishte kapluar tërë fshatin e mbushur përplot me nje rëz, tërë kolonën. ·Edhe shumë fëmijë tjerë më kishin rrethuar dhe me gojë hapur dëgjonin rrëfimet që ia thurja Artit. Arta dhe Blerina, tërë kohën nuk na u larguan. Aq sa kisha mundësi, mundohesha t'i mbroja këta fëmijë nga traumat dhe pasojat që mund të ngulitesin në kokat e tyre, natyrisht, nëse mbetemi gjallë. Nëse shpëtojmë, pikë së pari, i duhen vetvetes, të shëndoshë dhe të aftë për këtë jetë, që po sjellë gjithfarë peripetishë. I duhen

kombit tonë të lashtë, që edhe ashtu është tkurrur mjaft, nga vuajtjet shekullore dhe asimilimet e shumta nga pushtues të ndryshëm e të shumtë. Edhe përkundër situatës, momentalisht, pa shtegdalje për shpëtim, e dija se duhet te mundohem deri në momentin e fundit. Edhe në këto momente trishtuese mendja ime kujtonte ditët para shpërthimit të luftës. Kjo vdekje më dukej më e lehtë sesa një tjetër, nga metodat që lapsi dhe fjala assesi nuk mund t'i shprehin. Zemra me ndjenjte shpëtim, sido që të përfundojë. Madje, edhe nëse vdesim, do të bëhet më mirë sesa të jetojme si kemi jetuar dy dekadat e fundit.

Katet e kullës, në të cilën gjendeshim, binin copë-copë nga minahedhësit e forcave serbe, që nuk pushonin për asnjë moment. Vendosëm që të gjithë ta kalojmë natën ashtu, të ulur në bodrum. Rreth orës 22, mora Artin dhe e vendosa në dhomën ku flenim më parë, e cila nuk ishte dëmtuar ende. Pas meje erdhën

edhe 2-3 gra me femijë më të vegjel. Edhe kjo natë kaloi me të shtëna.

Më tej nuk mund të rrinim. Me datën tetë maj, në mëngjes, përkundër rrezikut të madh që na kanosej, vendosëm të nisemi drejt kufirit Kosovë–Shqipëri. Pas një serie gjuajtjesh nga forcat serbe, me lloj-lloj armësh, deri me ato më të rëndat, mbretëroi një pushim, të cilin e shfrytëzuam, dhe si të pashpirtë u grumbulluam. U nisëm drejt rrugës kryesore.

Prap kolonë. Në krye të saj, dikush mbante një shami të bardhë. Përnjeherë, bredhje të mëdha, forcash serbe kodrinave rreth nesh. Vazhduam të ecnim. Heshtur, për të dytën herë kalonim Urën e Gurit, mbi lumen që lejonte hyrjen dhe daljen në këtë fashat, tani magjik për ne. Më dukej se kuvendonim me të; na i ndjente vuajtjet. Vuajtjet që në mënyra të

ndryshme i kishte ndjerë edhe shumë herë më parë, së bashku me popullin tonë. Nga banorët e ketij fshati mësuam se kjo urë ishte ndertuar ne shekullin XII, me gurë të posaçëm, të marë në fshatin Gllarevë, afër Kjevës. Ishte ndërtuar me duart e zhdërvjellta të njerëzve që kishin prirje për këto gjëra, njerëzit me gjak mjeshtri që konstruktuan shume ura tjera nën të cilat lundronin anijet e ndryshme, me stil vetanak, nisur nga Liburnia... Duke kaluar mbi këtë urë, më dukej se më shtohej fuqia dhe optimizmi, vullneti për përpjekje me jetue. Më dukej se na jepnin kurajo mjeshtritë që e kishin ndërtue, të cilët për kondicion kishin ngrënë, siq tregonin fshatarët, sipas gojëdhënave brez pas brezi, 137 kg hudhra.

Pas kalimit te urës, në të dy anët e kolonës filloi qarkullim i paramilitarëve dhe militarëve serbë, të veshur në mënyra të ndryshme. Disa ishin të veshur me

rroba civile, ca të tjerë me uniforma ushtarake, të tjerët policë, disa të tjerë me veshje dhe me amblema çetnike, ca të tjerë me veshje kaubojësh, kokëtullacë, e në bel mbanin karikatorë plot fishekë. Të gjithë, në dorë mbanin armë automatike të drejtuara nga ne. Na frikësonin me shikime përbindëshe. Askush nuk bëzante. Artin e shtrëngoja për dore. Frikësohesha mos po fillon me pyetje të ndryshme, siç e kishte shprehi. Siç duket, e kuptonte fare mirë gjendjën në të cilën gjendeshim.

Kolona u ndal. Kalimi bëhej grupe-grupe, duke na përcjellë me sy. Në radhë erdhi edhe grupi im. Shikoja vetëm përpara. Afër nesh ishin ndalë dy paramilitarë, me fytyra të imta e thatanake, të shtrembëruara nga urrejtja. Urrejtje?! Pse?! Vetëm pse ekzistonim. Në gjuhën serbe, qartë e dëgjova njerin duke u betuar në nënë sesi pa fije mëshire do ta pushkatonte tërë kolonën. Vetëm pritëte urdhërin nga të tjerët. Në të vërtetë, nuk foli

kurfar çudie. Kjo, prej tyre mund të pritej në çdo moment. Për gjëra të tilla kishim dëgjuar mjaft.
Kaloi edhe grupi im, me rreth katërdhjetë vetë. Shpejtuam hapin që t'u bashkangj iteshim të tjerëve. Edhe 300 metra dhe kalonim në rrugën kryesore. Athua, do të na lejojnë të ecim drejt kufirit? Në fytyrat e të gjithëve vërehej kjo pyetje, e gërshetuar me frigë dhe tremë të madhe.
Britma grashë dhe fëmijësh! Britma, që thuase do të çmendeshe duke i dëgjuar. Ç'po ndodhë atje, afër rrugës kryesore, ku ishte një koncentrim i forcave të armatosura serbe?

- Po i ndajnë mashkujtë!

Nuk e di as vetë prej kujt i dëgjova këto fjalë, por e di se filluan të më ushtojnë veshët me të madhe dhe të më merren mendët. E mblodha vetën dhe shikova drejt atyre që i ndanin. Me duar lart dhe me fytyra kah muri i kishin mbështetur

mashkujt madhorë, afër një barake të zymtë, që shtonte tmerrin edhe më tepër.
- E morën Visarin! - m'u drejtua Edini i zbehur në fytyrë,që mezi i rrinin syzet nga tmerri.

Pa vonuar, nje fytyrë e shëmtuar iu afrua dhe i ra me armë në gjoks Edinit, që të largohej nga kolona.
- ‘’Ti çoravi!’’, - iu drejtua me fjalë që i përngjanin pikërisht stilit te tij.
Nëna e tij, dr. Sania, u doli përpara dhe i luti që mos ta merrnin, pasi që ende s'i kishte mbushur pesëmbëdhjetë vjet.
- Këta po na duhen! - ia ktheu ai, në gjuhën e tyre, me qëndrim që nuk përshruhet dot me fjalë.
Vazhdonin, pa humbur kohë, i merrnin të gjithë me radhë; prej rreth katërmbëdhjetë deri në rreth gjashtëdhjetë vjeç, duke i grumbulluar pranë asaj barake. Të gjitha gjërat që i bartnin ua merrnin dhe nuk lejonin t'i merrte askush prej të afërmve. Kryesisht, ishin çanta të mbushura me ushqim.

Kishte edhe gjëra të tjera të qmuara, që ishim munduar të bartnim…
Askush nuk donte të vazhdonte. Të gjithë qanin, vajtonin dhe bënin lutje, të përkulur në gjunjë.
Më kot. Pa mëshirë, duke na i marë të gjitha dokumentet e gjërat tjera me vlerë, me gjuajtje dhe kërcënime, na detyruan të vazhdojmë drejt Klinës, për të kaluar nëpër Prizren dhe për të arritur në Shqipëri. Këtë gjë deri tani e ëndërronim, por tani ishim të dehur. Ashtu të dehur ecnim, duke lëshuar këmbët të pasigurt ë. Të gjithë me lot në fytyrë dhe duke na u sjellë vërdallë nëpër mendje lajmet që na arrinin për fatin e djelmoshave dhe të burrave shqiptarë, të ndarë nga kolonat. Shumicën i ekzekutonin aty për aty, disa i burgosnin, e për fatin e shumicës nuk dihej asgjë. Nga çdo anë flitej sesi po hapen varreza masive. Me lutje i drejtohesha Zotit për jetën e këtyre njerëzve, e sidomos të të

afërmve të mi, nipave Visarit e Edinit, vellait tim Enverit, dhëndurve…
Artin e mbaja për dore. Në këto momente të vështira, për gjendjen e tij psikike kujdesej nana natyrë me lulet shumëngjyrëshe, që kishin lulëzuar. Për Artin, këto lule paraqitnin një botë çudirash.

Ai ishte thelluar thellë në atë botë. Vërente që diçka nuk ishte në rregull. Vëmendjën e orientonte kah lulet dhe fluturat. Asgjë nuk ndodhë rastësisht. Natyra, tani e luante rolin e vet, të nevojshëm për ruajtjen e filizave shqiptarë. Ato ishin lule të tokës shqiptare. Mundimet dhe dhembjet tona i ndjenin edhe gjallesat bimore, të mos flasim për ato shtazore. Pa kurfarë pyetjeje, ndalej Arti dhe këpuste lule, që pa më shikuar në fytyrë, m'i zgjaste me duart e tij të njoma, me plot dashuri e kujdes për to.

Përkundër brengosjeve të shumta, më shkoi mendja tek babai i Artit, dhe për të

parën herë ndjeva lehtësi që nuk gjendej me ne. Mundohesha, sadopak, t'i ngushëlloja me fjalë nënat për fëmijët e tyre. Nuk e di a kishin ndonjë efekt fjalët e mia? Vështirë!...

Ecëm kështu 3-4 orë. Nuk e di me çfarë force.

Herë pas here kolona të gjata të traktorëve kalonin pran nesh. E tërë Kosova zbrazej nga shqiptarët.

- Po vijnë, i kanë lëshue! – bërtiti dikush nga një traktor në lëvizje e sipër…

- Çka tha?!

- A është e mundur?!

- Joooo more, ku me e ditë çka tha!...

Të gjithë zgurdulluam sytë të habitur, e më shumë të frikësuar nga këto fjalë. Zemra filloi të na rrihte shumë. Të gjithë u drejtuam kah traktorët që ngritnin pluhurin

nga ushtima dhe pesha e madhe që tërhiqnin.

- O, po, po. Po vijnë!!! I kanë lëshue! – përgjigjeshin ata në pyetjet tona të pareshtura. Shpresa për jetë shkrepi në fytyrat e njerëzve që të dukeshin se në çdo moment vyshkeshin, sa nuk rrëzoheshin.

Tani, kur mendja m'u çlirua nga shtrëngimi, që për çdo moment më dukej se do të kaloj në çmendi, hetova sesi më rridhnin lotët dhe çlirohesha nga ankthi, që sa s'më pëlciste.

Të gjithë ngadalësuam hapin, por asnjeri nuk ishim të sigurtë se vërtetë janë liruar. Në largësi vërejtëm sesi disa njerëz ecnin me hapa të shpejtë. Ndër të parët vërejta Visarin, e pas tij të tjerët me radhë. Të gjithë u afroheshin familjeve të veta, duke i përqafuar të përlotur. Më në fund, pushuan lotët e Fëllanzës, vajzës së dajës

së Artit, e cila më dukej, siç thonë, edhe gurin po e shtjen në vaj.

"Po shpresojmë se nuk do të na ndodhë më një gjë e tillë" – këtë thonim dhe mendonim të gjithë…

Vazhduam rrugën. Ishim duke hyrë në Klinë. Forca të mëdha serbe të koncentruara nëpër tërë qytetin. Ecnim, thuase pa frymë. Mendonim se çka mund të na ndodhë në çdo hap. Përkundër të gjitha këtyre peripetive, ky qytet i vogël Kosovar më pëlqeu shumë.

Sa keq që nuk e kisha vizituar më parë. Përshtypje më të madhe të linte krenaria e Urës së Gurit, që qëndronte mbi lumin Dri i cili, këto ditë, më tepër bartëte gjak sesa ujë. Siç duket, ishte mësuar me këtë gjë. Dëshiroja t'a shikoja më mirë, por rreziku i madh nga largimi i kolonës, më shtyri që edhe unë, si gjithë të tjerët, të gjejë forcë për të shpejtuar. Nuk dihej se çfarë fati i priste ato grupe të vogla që nuk

kishin forcë t'a mbanin hapin me masën në kolonë.

Kaluam edhe këtë qytet, nga i cili shumë kolona para nesh i kishin kthyer mbrapa. Për fatin e tyre dëgjonim lloj-lloj lajmesh. Morem frymë pak më lehtë. Ushqim kishim fare pak. Para neve, në rrugën për Prizren, shtrihej një pjesë rruge më e veshtirë për ecje. Përpjetëz. Mundoheshim t'a shpejtonim hapin, por më kot. Të gjithë ishim të lodhur dhe të rraskapitur, si fizikisht ashtu edhe psiçikisht.

Krahas nesh kalonin shumë kolona të traktorëve, me shpejtësi dhe zhurmë, që na rraskapitnin edhe më tepër. I shikonin me lakmi dhe me sy lutës që mos, ndoshta, ndonjëri do të ketë meshirë të n'a ofrojë ndonjë skutë në vendet e lira, që kishin mjaft, së paku, për ndonjë të moshuar apo për ndonjë grua me fëmijë. Por, kot. Thuase, edhe më tepër jepnin

gas kur afroheshin pran nesh. Pluhuri që ngrisnin n'a jepte përgjegjje mjaft të qartë. Si nëpër mjegull shikonim me armiqësi shporetat me qyngat dhe saçët për të pjekur flia, që ishin vendosur aq kujdesshëm nëpër traktorët e mbingarkuar me sunxhere, me thasë mielli, tinarë me turshi…Shikimi më rrëshqitëte tek Arti, që në trup kishte të vetmet rroba dhe patikat gjysmë të grisura. E mbaja për dore, e vetëdijshme se e vetmja gjë e vlefshme për mua dhe për te është jeta e tij. Ma merr mendja se çdo njeri nga kjo luftë, si dhe nga çdo luftë e mëparshme, mëson diçka që e merr si një ndër parimet kryesore në jetën e mëtutjeshm, natyrisht, nëse arrinë të mbetet gjallë. Në mua, kjo luftë, po len gjurmë të thella. Po më duket se në këtë jetë njeriu habitet dhe jepet pas gjërave të ndryshme pa vlerë, siç është pasuria e tepërt, bukuria, karriera, lëvdatat e ndryshme. Njeriu nuk po e ditka se gjëja me e rëndësishme për të qenka të jetë, pikë së pari: i lire, shpirtërisht i mirë,

tolerant, i arsyeshëm, zemërgjerë, i kuptueshem... Vetëm njeriu i mirë qenka i pasur, i bukur dhe me të gjitha të mirat në këtë botë. Për këtë gjë shpesh kam lexuar, dhe shpesh na ka folë babai ynë, por njeriu kur bie në situata siç është kjo luftë, atëherë kjo gjë vërehet qartë. Këto gjëra duhet t'ia shpjegoj Artit, që vazhdimisht ma shtrëngonte dorën. Në dorën tjetër mbaja çantën, me ata pak ushqim që e kisha. Edhe përkunder gjërave të mbingarkuara në traktorët e panumërt që kalonin afër nesh, për të gjithë ne kishte vend, ashtu që me peripeti më të pakta do të kalonim këtë rrugë, që ende nuk ishim të sigurtë se a do t'a kalojmë të gjallë.

Arkivi I Kosovës/ Kosova 1999/ Foto nga Paul Refsdai_Gazetar Norvegjez

Edhe ata njerëz nëpër traktorë, ndoshta kishin arsye për sjellje të tilla. I kanë kapluar ethet e luftës. Frigë nga uria. Luftë për egzistencë. Kush e di me çfarë torturash janë larguar nga vatrat e tyre shekullore, nga shtëpitë e tyre, që tani nuk janë në gjendje të mendojnë arsyeshëm as për vete, e lëre më për ne që na dukej se çdo fije fati na e kishte kthyer shpinën.

Ecnim, uleshim. Ecnim, uleshim...

A thua a ka fund kjo ecje e jona? Në çdo udhëkryq patrulla policie serbe. Plaçkitje, maltretime, fyerje, sjellje shtazarake të një ushtrie veshur në rroba policësh dhe paramilitarësh.

…Një kolonë e madhe e traktorëve. Policia serbe i kontrollonte të gjithë me radhë. Edhe neve që ecnim, na ndalën.

- Hypni nëpër traktorë!!! – bërtiti njëri nga policët, natyrisht, në gjuhën e tij.

Me britma i urdhëroin pronarët e traktorëve që të na sigurojnë vende në traktorët e tyre.

Arkivi I Kosovës/ Kosova 1999/ Foto nga Paul Refsdai_Gazetar Norvegjez

Si të hypim? Asnjëri nuk n'a dëshironte. Pas pak, tre policë u afruan tek secili traktor, duke u kërcënuar se nëse nuk na marrin, edhe ata do të zbresin nga traktorët. Kuptuan, bile fare mirë. U ngushtuan pak dhe shumica e njerëzve nga kolona jonë gjetën vend nëpër traktorët e vargisur. Përnjëherë, na u duk se na buzëqeshi fati.

Traktorët u nisën. Një pjesë e kolonës tonë, me më të vjetër dhe me më shumë fëmijë, kishin mbetur mbrapa, kështu që ata mbetën ende duke ecë këmbë, në mëshirë të fatit…

Derisa u bë terr i dendur kaluam rreth pesëdhjetë kilometra. Kalona me traktorë, u ndal që t'a kalojmë natën në një hapsirë më të rrafshtë. Dymbëdhjetë vetë nga kolona ishim vendosë në një rimorkio traktori. Aty gjendeshin edhe dy gra dhe dy fëmijë. Dy burrat e tyre gjendeshin në kabinën e traktorit. Në mesin tonë gjindeshin dy të rinjë dhe dy të reja, që

filluan të tregojnë se si dy javë me parë, me një kolonë tjetër kishin arritë në Gjakovë. Atje, forcat serbe tërë kolonën e kishin kthyer mbrapa. Këta të rinjë ishin vendosë në një familje afër Klinës. Aty kishin qëndruar derisa kishte kaluar kolona jonë, që të n'a bashkangjitën. Dy prej tyre ishin nga fshati Zasellë, komuna e Mitrovicës, të familjes Nuhi, dhe dy të tjerë farefis të tyre nga fshati Oshlan. Nuk mundem pa i përmendur këta të rinj, meqë i dija shumë mirë vuajtjet dhe peripetitë e tyre, e nga ana tjetër, dukeshin sikur të kishin dalë nga sallonet më të shtrenjeta botërore për zbukurim. Bukuria e tyre ishte e thellë, e cila zhduket vetëm me vdekjen e tyre. Në gjestet e tyre vërehej vendosmëria, intelegjenca, krenaria dhe shumë virtyte tjera të trashëguara brez pas brezi. Duke i shikuar këta të rinjë, nuk e kemi vështirë t'a qëllojmë arsyen e këtij zullumi ndaj popullit tonë, nga një popull që vijnë nga vise të largëta, e me çdo kusht tentojnë në

uzurpimin dhe përvetësimin e kulturës tonë vetanake, të trashëguar me shekuj e mileniume... Zullum për të n'a zhdukë rrënjësisht nga trojet tona, për shkak të lakmisë dhe xhelozisë.

Artin e vendosa në një kënd, aq sa më lejuan thasët me ushqim. Disa jashtë, disa brenda, kaloi edhe kjo natë. Para agimit, të gjithë ishim të zgjuar. Në të vërtetë, pos fëmijëve, ne të rriturit fare pak kishim fjetë, për shkak të thasëve të shumtë. Nuk kishim vend as të mbështeteshim, duke rrëshqitur vazhdimisht.

Arkivi I Kosovës/ Kosova 1999/ Foto nga Paul Refsdai_Gazetar Norvegjez

Përgatiteshim për nisje. Pesë vetë, ngasës të traktorëve, ishin tubuar dhe nuk donin të niseshin. Në njërin nga ata traktorë kishte pasë përlamje, ngatërresa të pa kuptimta… Pronari kishte tubuar kushërinjtë e tij nga traktorët tjerë, duke i bindur që të na dëbonin nga traktorët e tyre. Pas shumë bisedave u detyruam të zbrisnim.

Prap ecje pafund. Tani kishte shumë rrezik, pasi që në numër ishim shumë më pak. Kalona ishte shpërndarë. Disa vazhduan me traktorë, ndërsa pjesa tjetër kishte ngelur shumë mbrapa. Nanë pse prap po ecim? Pse zbritëm nga traktori? - prap pyetje prekëse nga Arti kureshtar, duke më shikuar, për t'i kthyer përgjegje ngushëlluese. Kërkonte ngushëllim nga unë. Nuk e dija a mund të gjejë tani përgjegje ngushëlluese. E shikoja ëmbëlsisht, derisa më dukej se do të rrëzohesha nga mendimet shqetësuese.

- Gati mbërrimë, për këtë arsye zbritëm nga traktori. Ec edhe pak. Të ka nana djal sokol! - ia ktheva e pasigurt. Qartë vereja se po kupton çdo gjë. Vazhdonte te ecte me më pak pyetje.

Pas pak kohe, pran nesh kaloi kolona e traktorëve në të cilët kishim qenë disa orë më parë. Të gjithë mërmëritnim fjalë dëshpërimi, duke zbrazë në këtë mënyrë mllefin t'onë të arsyeshëm. Megjithatë, le të mbetet në ndërgjegjen e tyre, mendova me vete, pasi që shumë ditë më parë isha pajtuar me këtë gjendje në të cilën gjendesha tani.

Rrugës arritëm dy kolona të tjera të vogla, të cilat herë pas here pushonin, për shkak te numrit të madh të njerëzve të vjetër. Sadopak, ishte një lehtësim për ne, për shkak të rritjes së kolonës.

Filloi vapa. Tani na preokuponte mendimi për vështirësitë nga vapa e mundshme që mund të zgjaste. Lodheshim më

shpejtë. Edhe ato pak gjëra që i kishim në trup, tani na vinin rëndë. Nuk guxonim t'i gjuanim, pasi që motit nuk i dihej. Nuk e dinim ku do t'a kalonim natën. Nga vapa ndihej më tepër kundërmimi i qelbët i shtazëve të vrara. Këto qelbësira nuk kishin të mbaruar. Një qenë shtëpiak na përcillte, që nga orët e hershme të mëngjesit. Ecte krahas nesh. N'a vërente nga pamja, se nuk ishte i dëshiruar për shkak të kundërmimit. Edhe pse relativisht më larg, assesi nuk largohej prej nesh.

Artit ia pata zhveshur rrobat e trasha, dhe tani ecte vetëm me një këmishë të hollë. Në këtë gjendje vërehej më qartë se sa ishte dobësuar. Ishte bërë, siq thuhet, kockë e lëkurë. Gjatë tërë rrugës vazhdonte të zbavitej e të jetonte në bukurinë e zogjëve dhe të luleve, shpesh duke e këputur ndonjë. E futëte në qesën që tani e bartëte vet. Herë pas here ma

kujtonte se si po më ndihmon në bartjen e gjërave, duke e bartur atë qese me lule.

E, more bac, more gjyshi i Artit, sa i çuditshëm m'u pate dukur, kur para gjashtë-shtatë viteve, duke biseduar, pate thënë se: "Pas një kohe Serbia do të na ngarkojë në autobusë, e do të na shkarkojë jashtë kufirit". Faleminderit prej Perendisë që vdiqe para tre muajve dhe nuk po e përjeton edhe më keq se sa e parashikove. Sikur të na bartnin me autobusë, do ta kishim më lehtë, por po na debojnë, duke na detyruar të ecim kembë, pa pasë ku me u kthye, duke mos na lënë të ikim të qetë, nga maltretimet më të tmerrshme që ekzistojnë, deri te masakrimet e pleqve, plakave, grave shtatzëna dhe fëmijëve. Këtë gjë nuk e pate parashikuar, edhe pse shumë, shumë gjera që na ke folë, janë bërë realitet. More bac, more Hashim Shala, sa shumë e deshte këtë nip, Artin e vogël. Edhe pse të zgjonte para mëngjesit, gjithmonë vije dhe me ngrohtësi e merrje në dhomën tënde, duke e pajtuar ashtu siç

dije ti, me ndonjë kokërr sheqer, lugë mjaltë, llokum, ndonjë arrë... Kurrë nuk të mërziste.

Gjyshërit e Artit

14.

Mbi qiell filluan të paraqitën disa re. Shpejt e shpejt vesha Artin, ia mbatha patikat, dhe kështu vazhduam me frigë se mos po fillon ndonjë shi i madh. Për fat të mirë, pos disa riga të lehta, nuk u paraqit ndonjë mot i ligë.

Një tabelë komunikacioni: ‘Krusha e Madhe’. Ditët e fundit është folë mjaft rreth fatit të një kolone që kishte kaluar nëpër këtë trevë. Ishte ndarë kolona në dysh. Gjysma e parë ishte lejuar t’a

vazhdonte rrugën, ndërsa për gjusmën e dytë fati kishte qenë i zi. Thuhej se njerëzit i kishin ndarë në grupe dhe i kishin shpërndarë nëpër vende të ndryshme. Ishin vrarë e masakruar me mënyrat më mizore.

Kalonim të heshtur, duke shikuar përreth. Në të hyrë të kësaj zone në të djathtë vërejta që dy-tre pjesëtarë tonë flisnin me një njeri që zbuloi kokën e mbuluar me bari në një thellësi (gropë) të padukshme. Biseduan shkurt. Vazhduam pa bërë zë, që pak më vonë na trguan se i panjohuri kishte prezentuar veten – ushtar i UÇK-së. Prap vazhduam, të pasigurtë se njerëzit tonë mund të jenë të sigurtë në një zonë si kjo… Situatë e vështirë dhe e pasigurtë…

Arkivi I Kosovës/ Kosova 1999 / Foto nga Paul Refsdai_Gazetar Norvegjez

Ç’të shohim? Shkrumb e hi. Si nuk e paskan harruar asnjë shtëpi pa e djegur. Edhe kështu të djegura, ato ruanin krenarinë e vet, me bukuri natyrore rreth e rrotull tyre.

Arkivi I Kosovës/ Kosova 1999/ Foto nga Paul Refsdai_Gazetar Norvegjez

Të nemitur ecnim duke menduar për fatin e atyre njerëzve që kanë banuar këtu. Fati i njejtë, sikur i të gjithë shqiptarëve të Kosovës. Ah! Shqiptarët e Kosovës - Kosova. Shumë e shumë legjenda, këngë e vjersha janë thurë për ta, që të gufon zemra sa herë që i dëgjon. A është e mundur të përsëritet prap historia dhe të biem në këtë nivel kaq të mjerë? Jemi pjesëtarë të dramës së zbrazjes totale e rrënqethëse të Kosovës. Kurfar mundësie

nuk po kemi ta ndalemi këtë proces… a thua pse... Ç'do të bëhet më tej? Së pari, të mbetemi gjallë e për më tej....

Të lodhur dhe të uritur, me shpresa shumë të vogla vazhdojmë të ecim me gjithë forcën që po na zvogëlohet vazhdimisht. Pasi që ishte pasdite, traktorë kalonin gjithnjë e me pak. Sa herë që dukej ndonjë, lindëte ndonjë fije shprese se, ndoshta do të gjendet ndonjë vend për Artin e vogël që, pa u ankuar fare, ende po qëndron. Me shpresa të kota vazhdonim të shikonim mbrapa, mos po luan ndonjë gjë. Sa lehtë beson njeriu në ndonje gjë kur ajo nevojitët, madje edhe nëse është e pamundur.

Në vesh më ra një cingerimë e një zileje. Më bëhej se po e shoh një kope me dele, ku dashi krenar me zile ne qafë, u prinë nëpër kullosa, që ua shtojnë bukurinë dhe urtësinë e tyre. Nuk ishte kope delesh. Një kali, me vështirësi tërhiqte në

përpjetëz qerren e mbingarkuar, pas së cilës ishte e varur zilja. Jo, për Artin nuk mund të ketë vend, pasi që ishte familje shumë anëtarëshe. Me kokë ulur, ngadalësuam hapin dhe prisnim të na kalonte qerrja e tërhequr nga ai kali i lodhur nëpër këtë përpjetëz, që dukej e pafund.

- A je lodhë, ooo çun? Hip këtu, çlodhu pak!

Thuase, nga qielli më erdhi një zë që nuk e prisja fare. Ishte zëri i një burri, i cili i printe qerres dhe e tërhiqte kalin, që sadopak t'ia lehtësonte barrën nga e cila ishte djersitur i tëri.

Pa menduar fare, shpejt e shpejt mora Artin para duarve dhe e vura në cep të qerrës. A është e mundur? Nuk mund të besoja se dikush e vërejti këtë fëmijë dhe i bëri vend për ta bartur. Ishte momenti kur më së paku e prisja këtë gjë, sidomos nga një njeri me kali, që edhe vet ecte këmbë dhe ishte shumë i shqetësuar për lodhjen e

kalit. Ecja krahas qerrës, duke e mbajtur Artin për krahu me njërën dorë. Madje, mos të kishte vuajtur nga ajo barkëqitje! Herë pas here, merrte fryme thellë nga kënaqësia e qerrës, dhe më dukej se me sy po më ngushëllon. Sikur donte të më thoshte: A po e sheh se do t'ia dalim!

Përpjetëza vazhdonte, kali lodhej ndërsa unë isha mbushur frymë duke ecë më shpejt se zakonisht. Kështu vazhduam deri në breg. Atje zbrita Artin. E falenderova njeriun zemërgjerë dhe u ndala ta prisja kolonën që kishte mbetur më mbrapa. Nga një qerre pas nesh, po ashtu e tërhequr me kali, zbriten dy gra të moshuara, njera prej tyre ishte nana ime. Pronarët u ulën mbi qerret e tyre dhe u larguan me shpejtësi më të madhe. Ne vazhduam me hapa më të lehtë, pasi që përpjetëza e madhe mori fund.

Arritëm në Landovicë. Shumë herë e kishim përmenduar këtë përmendore. Sa e sa herë kisha recituar para saj vjershën

"Ramiz o vlla", me ratin e festave të ndryshme gjatë socializmit…

Socializëm! Komunizëm! Më mirë me thanë hiri i socializmit dhe i komunizmit. Hi për sytë tonë që të mos vërejmë planet që thureshin me dekada nga grabitçarët, të gatshëm për sulm dhe grabitje të trojeve, kulturës, simboleve dhe të të gjitha dokeve tona. A thua, a e kemi ditë këtë gjë?…HË!!!

Uji i akullt i kroit të Landovicës na i kthjelloi sytë, për ta shikuar edhe më mirë rrafshin e Dukagjinit; për t'i vërejtur më mirë shkronjat e kanunit të Lekës, të cilat thuase notojnë nëpër ajër. Freski që nuk mund të ngopesh me të, por duhet të ngropemi, pasi që pa e lagur mirë fytyrën, na rrethuan tre policë, për të na përkujtuar se duhet të shpejtojmë. Shpejt e shpejt freskova Artin. Shumë njerëz të moshuar ishin ulur, të djersitur e të lodhur për vdekje. Disa kishin mbetur ende

mbrapa. Njëri nga policët na u afrua dhe na pyeste se prej nga vinim, që ishim lodhur aq shumë. Pas nje bisede të shkurtër, na tha të pritnim pak, ndoshta do të kalonte ndonjë mjet transporti dhe të na fuste disi në të. Nata afrohej, me ç'rast na e bëri me dije se gjindeshim në zonë të ligë e të rrezikshme për udhëtim apo qëndrim natën. Edhe ai e dinte se pa forcë policore vështirë se do të ndalej ndokush të na merrte. Ndaloi të qëndronte bashkë me ne që, sipas mundësisë, të na ndihmonte. Filloi të fliste për ardhjen e tij në këtë vend nga Kryshevci, pa dëshirën e tij, i thirrur nga UDB-ja dhe i veshur për të shërbyer për interesa të tyre…

U ulëm në cep të rrugës. Pas pak çastesh një patrullë e policëve u ndal dhe thirri policin që qëndronte me ne. E pyeti për ne, dhe e siguroi se vetëm nga një shenjë e tij, do të na heshtnin menjëherë të gjithëve, natyrisht, në mënyrën e tyre. Për fatin tonë, me fjalë të mira, ky njeri i mirë i

largoi. I brengosur na tha se kur të bie nata, nuk mund të na ndihmojë.

Pas rreth gjysmë ore arritën dy autobusë. I ndaloi polici që premtoi më parë. Përkundër refuzimeve të vozitësve dhe të udhëtarëve, për shkak të peshës së rëndë, me kërcënime nga njeriu që e tuakuam, me vështirësi të mëdha, disi, u futëm.

Thuase hymë për së gjalli në furrë. Autobus që bartëte gra e fëmije nga Drenica. Të gjithë mashkujt madhorë kishin mbetur në male. Shoferi dhe konduktori vozitnin të nemitur për të grabitur sa më shumë nga këta njerëz të gjorë. Isha kah f illimi dhe vëreja mosdisponimin e tyre. U morën vesh diçka ndërmjet veti me gjuhën aziatike dhe na u drejtuan se çdonjëri nga ne duhet të paguaj për të na bartë deri në kufi. Nuk i meritonin dhe nuk ishim të detyruar të paguanim asgjë. Të lodhur, të rraskapituir e të frikësuar nga vuajtjet, ne, shtatëmbedhjetë vetë, dorëzuam 200 DM.

Të ndrydhur, disi qëndronim. Në këto momente Arti filloi ta humbaste durimin nga tollovia dhe temperatua e lartë. Kalonim nëpër Prizren. A thua, ç'fat ka përjetuar në këtë luftë tezja e Artit, Myberaja, që jeton në këtë qytet, e cila që ditën e parë të bombardimit mbi forcat serbe nga NATO, e kishte lindë me prerje cezare Nolin e vogël, në repartet mjekësore "Nëna Terezë", në Prishtinë. Asgjë nuk dinim për fatin e tyre. Më mirë të mos mendojmë çka ka mundur me i ndodhë. Për ta kam menduar mjaft, por kur filluan vështirësitë e mia me Artin në kolonë, mendimi për ta m'u largua në masë të madhe.

Autobusi tani u nis një përpjetëze. Shkonim drejt Zhurit. Edhe pse në gjendje mjaft të vështirë, atje arritëm shpejt.

Zbritëm nga autobusi. Masë e madhe njerëzish, shumë traktorë, shumë vetura, shumë autobusë që kishin bartur njerëz, te cilët si të dehur, të tronditur nga torturat dhe nga rreziqet e shumta, ishin nisë drejt

kufirit shpërimtar, për të kaluar në Shqipëri. Edhe pesë kilometra e gjysmë deri në kufi.

15.

Ngadale po bie muzgu. A do të arrijmë para mbrëmjes. Duhet të arrijmë. Nuk dihet ç'do të bëhet më tej. Mund të mbyllet kufiri. Shpejt e shpejt u renditëm dhe iu bashkangjitëm kolonës së gjatë, thuase maratonike. Në mes të rrugës, gjithnjë vija e tërhequr për ne. Herë pas here, dëgjoheshin zëra që bërtitnin, për të mos u larguar nga vija, për shkak të rrezikut nga minat, që thuhej se ishin vendosur në të dy anët e rrugës.

Prap riga shiu. Prap qante qielli për njerëz të pafat. Po, vërtetë të pafat qenkan njerëzit që lëshojnë vendin e vet. Këtë fat populli i Kosovës e ka që moti. Një gjë të tillë vetëm po e vazhdojmë. Nxora çadrën që e mbaja në çanten e ushqimit të Artit, të cilën që nga mëngjesi e bartëte

tezja Sanija. Shpejt e mbylla, pasi që më shumë më sillte telashe sesa më mbronte, duke iu lakuar telat e thyer dhe duke më tërhequr në drejtim të erës. Artit ia vesha një mbrojtëse ere, të cilën ia kishte dhënë Fëllanza. Meqë ishte mjaft e madhe, e mbronte të tërin deri në fund të këmbëve. Në fillim e mbronte nga shiu, derisa u lag tepër dhe filloi ta lëshonte ujin. Edhe pse pa ushqim, madje edhe pa ujë, të lagur, disi ndjeheshim më të fortë, pasi që e dinim se ishim afruar afër kufirit. Si këpurdha pas shiut, vende-vende, para neve mbinin njerëz të armatosur me maska të zeza, të cilëve u dukeshin vetëm sytë.

Na fshinë nga faqja e dheut, nga faqja e Kosoves. Ç'do të bëhet më tej. Kurrë nuk kam besuar se do të kenë mundësi të na e bëjnë këtë të zezë. Në Zot besoj shume! Kjo po më ndihmon pa masë. Sa mirë qenka të besosh në një fuqi rregullatore të kësaj bote. Nëse nuk gjen rrugëdalje, mendo në Perendinë që të qetësohesh.

Në çdo hap dëgjonim rrëfimet e njerëzve për peripetitë e mundimshme që i kishin kaluar gjatë udhëtimit. Maltretime, plaçkitje, rrahje, kidnapime, vrasje, masakrime...

Këto komente ndiheshin përgjat kësaj zone që ishte mjaft afër kufirit, përgjat fshatit Vërbicë, që shtrihej buzë liqenit të kthjellët, i cili thuase bisedonte me trurin tonë dhe na i dinte të gjitha hallet.

Rreth nesh ngriheshin shtëpi që me stilin e tyre të tregonin se kush i kishte ndërtuar. Të tregonin se i kishin ndërtuar gurbetçinjtë Kosovarë. Edhe pse shumë të bukura dhe të meremetuara per mrekulli, rrallëkush nuk mund ta vërente se nëpër to rridhte djersë kosovare, e derdhur në tokat perendimore, djersa e të rinjëve pa rini. Hija e zymtë i kishte kapluar. A do të largohet ky mjerim ndonjëherë?...

Homo homonis lupus est – Njeriu për njeriun është ujk. Shprehje e njohur latine.

Ku nuk pritet fare, të lëndon dhe të jep plagë që, ndoshta, nuk do të shërohet kurrë. Këtë plagë mund ta fitojmë edhe nga anëtarët më të afërt të familjes, apo edhe nga miqtë më 'të mirë'. Mirëpo, kur njeriu vret pleq, fëmijë në djep, gra, madje edhe shtatzëna, atëherë për këtë gjë nuk ka kurfarë thënie apo komenti. Ajo qenie nuk ka të drejtë ta quaj vetën njeri, përpos një bishë grabitçare... Shqiponja në këto troje nuk do të shkatërrohet pa u shkatërrua vet trualli - toka shqiptare, Kosova bashkë me Shqipërinë. Ah! Shqipëri! Shtrëngoja dorën Kosovës!...

Krahas nesh, prap kolona traktorësh. Tani, ne i kalonim ata. Afroheshim afër kufirit dhe zemra na rrahte me shpejtësi. Nga të dy anët e rrugës thasë të panumërt me ushqim të ndryshëm, e sidomos me miell. I kishin hedhur nga trakto rët. Shumë njerëzve do t'u zvogëloheshin mundimet e udhëtimit po të kishin qenë nëpër traktorë, në vend të këtyre gjërave, tani të hudhura.

Arkivi I Kosovës/ Kosova 1999/ Foto nga Paul Refsdai_Gazetar Norvegjez

Dogana Jugosllave në kufi. Kërcënime të hatashme për dorëzimin e të gjitha dokumentevе. Maltretime të panevojshme dhe zhurmë e tmerrshme nga gdo anë. Kjo gjendje edhe më tepër rritej nga lodhja, nga etja dhe nga uria. Përkundër këtyre rrethanave, syri më shkoi në një pikë pak më larg. A është e mundur ta shoh atë që po e shoh? Flamuri ynë! Më dukej ëndërr. A do të mund të arrijë ndonjëherë nën atë flamur, për të cilin dikur nuk kemi guxuar

as të pështpërisim. Sa krenar po valon! Lart, lart! Po me duket se asnjë flamur në botë nuk mund të valojë sikur ky, që tani jam duke e shikuar kaq afër, e njëkohësisht po më duket se nuk do ta arrijë kurrë... Më e gjatë më dukej kjo pjesëz e rrugës, gjer nën flamurin kuq e zi, sesa nga Mitrovica deri këtu. Pa dashje, u ktheva kah bashkëudhëtarët e mi, me shikim pyetës. Sigurisht edhe këta të gjithë e kanë të njejtën ndjenjë, edhe pse po më duken pak si të painteresuar për këtë gjë. Çdo hap i imi më dukej se po me thotë: po afrohesh, po afrohesh!... Artin, e shtrëngoja për dore edhe më shumë. Këto momente janë mjaft të rëndësishme për te. Do t'i flas për këtë moment, për shpresën e tij, për mundësinë e tij që të ekzistojë, për simbolin përballë, që i dha dhe do ta mbajë me identitet.

Arritëm! Arritëm tek dogana Shqiptare! Doganë rrënjësisht e ndryshme nga ajo e mëparshmja. Doganë me fjalë dominante:

- MIRË SE ERDHËT!!!

Dogana mbi të cilën valon shqiponja krahëhapur për ne, e zezë në të kuqe.

Po, po! Nuk është ëndërr. Po më valon mbi kokë flamuri i merituar i popullit tim. Flamur krenar që nga stërgjyshërit tanë më të lashtë.

Si nëpër mjegull shoh se më afrohen dy djem me mantela të bardhë, si erë malesh. Kush janë dhe çka kërkojnë? Janë vëllezër shqiptarë që rrezatojnë mirësi e mikpritje, gatishmëri të paparë për ndihmë. Njëri ofron dy gota qumësht të nxehtë. Jo, nuk mund të thuhet të nxehtë, por të ngrohtë. E mora dhe për një moment m'u duk se po e ndjejë aromën e kullosave që, të lira e pa robëri, kanë rritur barin dhe lulet për bagëtinë e urtë…

Më ndërpreu nga këto ndjenja zëri i Artit, kur si me vështirësi shqiptoi fjalen: tamel! Shikova duart e njoma, mjaft te lodhura,

që ishin zgjatë kah gota e bardhë, e mbushur me qumështë të nxehtë. Në fillim, nuk desha t'ia epja, pasi që mu duk tepër të nxehtë për te. Filloi të dëneste dhimbshëm duke e kërkuar, pa durim për të pritur të ftohet pak. Ofroi buzët e thara dhe aspak nuk i pengoi nxehtësia e tij. Thithte me ëndje të njejtën aromë sikur gjithë të tjerët. Më dukej se i kthehej freskia që diku thellë në brendi e kishte ruajtur për truallin e lirë shqiptar. E piu të tërin.

Gota nga e cila Arti piu qumshtin me të hyrë në Shqipëri (Nga koleksioni familjar)

Menjeherë, u afrua djaloshi tjetër me dy gota të tjera.

- Urdhëroni, motër, pak çaj! - na u drejtua dhe vazhdoi t'i shërbente të gjithë me radhë me fjalë të ëmbla, ku lehtë vërehej se i buronin nga shpirti, thuase i kishin përjetuar vuajtjet e rrugës bashk me ne.

Arti nuk deshti çaj. Mbante gotën e qumështit në dorë, e shtrëngonte në gjoks. Të mahniste disponimi dhe këndaqësia e tij, qëndrimi me ndjenjë të sigurisë.

Pija çajin, duke ndjerë arom mali. Çaj mali. Çaj i maleve të larta e të lira. Tërë jetën time do ta kujtoj këtë aromë dhe nuk do ta harroj shijen e tij.

- Batanie, batanie! - degjoheshin zëra vëllazëror nga ana tjetër. Afër tyre, të tjerët thërrisnin për ushqim. Më larg personeli tjetër i përcillte njerëzit e lodhur e të rraskapitur deri tek autobusët e ndryshëm, që ishin siguruar për ne.

Oh Zot! Po më duket, u zgjova nga një ëndërr trishtuese dhe dola në këtë parajsë

që po e qetëson dhe po e kënaqë çdo qelizë të qenies tonë.

16.

Ndjenjë e papërshkruar gëzimi!

Po. Vërtetë kaluam kufirin e rrezikut. Disa, të gëzuar kthejnë forcën duke përkujtuar dyert e hapura të të gjithë botës, që të tmerruar nga skenat dhe faktet e gjalla e të vërteta, kanë hapur dyert për të na strehuar. Fakte të vërteta të gjenocidit serb ndaj një populli të pafajshëm; fakte këto që vëllezërit tonë shqiptarë, bashkë me ata në mërgim, arritën t'i përhapin dhe të informojnë në çdo mënyrë të mundshme.

Foto_huazuar nga mediat

Nuk na kishte mbetur rrugëdalje tjetër, vetëm të ikim diku larg nga përbindëshat…

Jo! Nga ethet e tmerreve, ende nuk jemi tërësisht të vetëdijshëm se ku kemi arritë. Kemi arritë tek gjaku ynë, që thellësisht po i ndajmë dhimbjet dhe vuajtjet tona. Do të na i shkrijnë këto ethe. Në mënyrë vëllazërore do të na tubojnë dhe do të na ruajnë që të mos na përbijë bota, si mushkonja të dëbuara. Do të kthehemi në trojet tona.

Të gjithë, i madh e i vogël, i vjetër e i ri, të gjitha strukturat Shqiptare, ekonomike e shoqërore, të gjithë janë të një mendimi dhe mbajnë qëndrim unik – Kosovarët në Kosovë, assesi jashtë saj, pa marrë parasysh vështirësitë, të cilat njihen nga e gjithë bota. Bota nuk e di se këto vështirësi nuk ekzistojnë vetem kur është fjala për Kosovarët. Ne jemi një. Këto vështirësi, në mënyrë të njejtë i kemi ndjerë, dhe së bashku do t'i luftojmë. Ndjejmë ndjenjat e gjakut ilir, që nuk mundi t'i shuaj asnjë barbar, madje as mbeturinat e tyre. Kurse ne, ashtu të lodhur, të uritur, me ethe, ende nuk jemi të vetëdijshëm se çfarë vendimi madhështor historik, kanë marë vëllezërit tanë shqiptarë. Shumë shpejtë na i shkrinë ethet, pa hetuar fare, na i kthyen mendimet e arsyeshme, që aq shumë ishin të ngulitura heshtur në kokën e shumicës prej nesh, por në momentin më

kritik na i ruajtën njerëzit e Nanës Shqipëri.

E ulur në autobus, hetoja se më kishte kapluar një ndjenjë e ngrohtë, e qetë. Këtë ndjenjë njeriu mund ta ketë vetëm në shtëpinë e vet, ku lindë, rritet dhe mund ta pushojë trurin. Ishim të përcjellur nga reporterë dhe gazetarë të shumtë, të cilët në këtë moment, tek ne nuk zgjonin kurrfarë interesimi, pasi që e dinim se kurrë nuk mund t'i dinë vuajtjet tona, pa marë parasysh dukjen dhe rrëfimet tona. Me ushqim të bollshëm, u nisëm në drejtim të Kukësit madhështor, me liqenin e qetë dhe bjeshkën e merituar buzë qytetit, ku gjurmët e borës ia jepnin bukurinë që menjëherë të shkonte mendja tek piktorët më të njohur botëror, të cilët nga pamundësia e pikturimit të një pamje të tillë, do ta vrojtonin me zili. Pendat e ngritura afër kësaj bjeshke, plot me Kosovarë, thuase flisnin me te, dhe i

përngjante një kuvendi madhështor, që do të lë gjurmë të thellë në historinë tonë.

Kukësi 1999_Foto e huazuar nga mediat

Kukësi 1999_Foto e huazuar nga mediat

Në Kukës qëndruam dy net. Artit dukshëm i përmirësohej gjendja shëndetësore. Ditën e tretë, para mengjesit u nisëm për në Elbasanin e bukur. Rruga gjarpëronte kah bjeshkët e shumta, të cilat heshturazi na uronin mirëseardhje. Në çdo vend, në çdo krua që freskoheshim, në çdo lum, në çdo urë, kudo më dukej se dëgjoja mirëseardhje.

Në mbrëmje arritëm ne qytetin që aq shumë e kishim kenduar si femijë:

''Vajzat si sorkadhe, djemtë porsi petrita,

hedhin këngë e valle anembanë,
si ylber me ngjyra, vezullojnë dritat,

Elbasan i bukur, Elbasaaaaan!...''

Me të arritur në Elbasan, përmes axhës Blerim të Artit, që gjendej në Belgjikë, vumë kontakte me babin e Artit, i cili kishte arritur një ditë më parë në Tiranë, me

peripeti më të vogla sesa ne, arritur gjatë një dite me një autobus. Arritëm në Tiranë, për të qëndruar një muaj. Pritnim të kthehemi në Kosovën e lirë. Më dymbëdhjetë qershor 1999, pritja na u shpagua,

MREKULLIA NDODHI!!!...

Kosova u çlirua!

Forcat serbe po terhiqën... Gatishmëri e paparë e shqiptarëve të Kosovës për t'u kthyer në Kosovën e lirë, përkunder apelit të OSBE-së dhe mediave për rrezikun e madh nga minat, që okupatori i kishte vendosë duke u tërhequr. Edhe Organizatat tjera Botërore për qështje sigurie rekomandonin që kthimi të kryhej më vonë. Hë! Si të presim!?...

Duhet të nisemi sa më parë. Flamuri me shqiponjën dykrerësh u var mbi shtëpinë në të cilën ishim vendosë. Ne, femrat përgatitëm darkë për të gjithë të pranishmit, që vendosëm ta festojmë këtë

madhështi në kryeqytetin shqiptar. Në ndejë festimi u ftuan edhe fqinjtë tanë në Tiranë. Në mbrëmje u grumbulluan të gjithë. Fqinjtë tiranas, të shoqëruar nga gratë e tyre, ua terhiqnin vërejtjën burrave tanë që t'i çrrenjosim, më në fund, fanatizmat e mbetuirinave që kanë mbetur nga pushtuesi turk…

17.

Mbrëmje festive. Plot këngë, valle dhe recitime nga poetesha e re nga Prishtina, Kaltrinë Kelmendi, e cila në çdo çast thurte nga një vjershë. Kulmin e festimit e shenonte edhe krisma e automatikut të fqinjit tonë. Krismë gëzimi, gëzim që buronte nga zemrat e të gjithëve. Gëzimi rridhte e dhe nga kërcimet e pabrenga të Artit. Çdo lëvizje e përcillte me interesim të madh. Nga gëzimi i madh kërcente edhe më shumë derisa u rrëzua dhe preku një damar në ballë. Damar shqiptari, ku menjeherë filloi të vlojë gjaku i kuq si flamur i që po i valon mbi kokë. Derisa

intervenuam dhe ia pastruam ballin, nuk i ndahej shoqja e tij Blerina, nga Prishtina, që me aq kënaqesi loznin e hanin së bashku.

Afrohej mesnata. Më kot u mundova ta dërgoj Artin për të fjetur. Donte të rrinte deri ne fund të ahengut, që vazhdoi edhe për shumë kohë. Siç duket, ende po dyshojmë në qëndrimin e Artit _ 3-vjeçar

Arti_Janar 1999

I ka qëndruar rrugës 22 ditëshe, plot rreziqe, Mitrovicë-Shqipëri, për t'u kthyer në Kosovën e lirë, në të cilën hymë më njëzet qershor 1999. Në të vërtetë,

vazhduam rrugën për në Kosovë, pasi që tani kufi të vërtetë nuk kishte.

Rrugët ishin të mbingarkuara nga kolonat me automjete të ndryshme, që bartnin Kosovarë, të cilët pa pritur kthimin e organizuar nga organet shtetërore, ktheheshin në Kosovën e lirë. Nëpër mendje prap, sikur vetëtimë, kaloi për një moment data e 17 prillit të po të njejtit vit, kur edhe kishim vendosë ta lëshojmë Kosovën. Edhe sa e sa ngjarje trishtuese kanë ngjarë po në këtë ditë. Thuase ka qenë një shekull. Të gjitha do t'i dëgjojmë dhe do të formohet një histori e shkruar me gjak.

Kosova! Te gjithë qëndronim me frigën pezull dhe me shikime pak a shumë të trishta. A thua ç'ka ndodhë me njerëzit e mbetur aty, që për këtë apo atë arsye nuk kanë mundur të largohen? Shumica kanë hipur në male, por a kanë pasë kushte për ekzistencë? Ç'ka ndodhë me vatrat tona? Kështu, me plot mendime vazhduam

rrugën, nën flamurin tonë që valonte anekënd Kosovës. Edhe pse me çimim mjaft të lartë, liria kishte arritë. Këtë liri do ta ruajmë siç i kemi ruajtë këta vocrrakë nga dora gjakpirëse e armikut, që mori shumë prej tyre.

Pesëdhjetëegjashtë viktima të familjes së Jasharajve, në mesin e të cilëve gjashtëmbëdhjetë filiza të lules së fëmijerisë, nisën çmimin e kësaj lirie, për të vazhduar shumë e shumë të tjerë, që toka shqiptare do t'i mbajë gjallë përgjithmonë. Legjenda për ta nuk do të shuhet kurrë. Tregimet dhe vjershat për ta do të thuren përgjithmonë, gjatë gjithë histories ...

- Lavdi u qoftë!

- Lavdi u qoftë të gjithë dëshmorëve dhe herojve që u flijuan për këtë liri!...

Arti i gëzuar porsa pa sërish qytetin e minatoreve, na befasoi me pyetjën e tij, që të gjithë të pranishmit kthyem kokën drejt tij;

PO, e kthyem shiqimin nga ai, nga pyetje e tij – ‘’KU ËSHTË URA E IBRIT?’’

Frigë më nuk ndjente, por kërkoi nga unë t'ia thosha një këngë…

RECENSIONE

DRAMA FAMILJARE E MBRUMUR ME KOMBËTAREN

Dorëshkrimi i Drita Shala – Çunakut, "KOLONA E UDHËS SË DJEGUR", ngërthen në vete gjithë dramën e hidhur fami ljare, që mbrumet thellë me kombëtaren e rrezikuar shqiptare jashtë çdo mase.

Një periudhë jetësore e kaluar në kolonën e njerëzve të luftës së fundit çlirimtare të UÇK-së e gjenë edhe Artin e vogël trevjeçar, i cili, plotësisht i pafajshëm, sikur të gjithë të tjerët moshatarë të tij, përjeton rëndë goditjet e pamëshirshme të kësaj lufte, pa babanë pran dhe pa ditur se ku do ta shpie fati, me nënën e munduar me te dhe të stërngarkuar për ardhmerinë e fatit të tij, siç do ta projektonte për fëmijën e vet çdo nënë e mirëfilltë shqiptare.

Brengat dhe vuajtjet e përditshme të Artit, të bashkëmoshatarëve të tij si dhe të të gjithë të tjerëve në ato kolona tmerri, të së ëmës, të të afërmve, të shokëve dhe të shoqeve të tij, nëpër atë kolonë njerëzish që kalonte nëpër rrugët e ferrit sërb, në tokën e tyre stërgjyshore, sikur nuk kishin të shterur...

Kolonën e përbënin njerëz të të gjitha profesioneve, por, këtu, më të vyeshmit ishin ata që u duheshin njerëzve në këto ditë të vështira, mjekët, Dr. Sania, Dr. Shaqiri etj., të cilët i perjetojnë rëndë torturat dhe plaçkitjet që u bëhen atyre...

Libri është i përjetuar thellë, drejtpërdrejt, dhe autorja ia arrin qëllimit të saj fisnik e njerëzor. E mbarështron guximshëm fatin familjar dhe kombëtar të shqiptarit të ndjekur e të persekutuar përherë nga shkiet dhe nga shumë shqipfolës të tjerë që u begatuan e po begatohen edhe sot në fatkeqësinë e popullit të tyre.

Ky libër është dëshmi e gjallë e katrahures së fundshekullit kundërshqiptarë.

Tafil Duraku

PROZË E FRYMËZUAR NGA REALITETI I LUFTËS SË FUNDIT NË KOSOVË

S'ka dyshim se Drita Shala-Çunaku frymëzimin për prozën e vet me titull "Kolona e udhës së djegur" e ka gjetur në ngjarjet e luftës, përkatësisht deportimit të popullatës shqiptare, që u bë me dhunë nga forcat serbe. Këtë e dëshmon në përshkrimin që i bën udhëtimit të rëndë me plot sakrifica që nga Mitrovica e gjer në Shqipëri. Në qendër të kesaj proze në formë ditari është djali Arti, të cilin Drita Shala-Çunaku e ngritë në shkallë të lartë në krahasim me personazhet tjera. Lexuesi nuk do ta ketë vështirë ta njohë, meqë s'ka pothuaj familje që nuk pati një fëmije të tillë gjatë luftës së fundit. Kësaj here, autorja bën një përshkrim tepër të dhembshëm, ku flet për rrugëtimin e dhjetëra, qindra familjeve, fut elemente të ndryshme që

kanë të bëjnë me mundimet e tyre, vuajtjet dhe sakrificen e të gjithë atyre që ndihmuan këta "udhëtarë biblikë", për t'i shpëtuar shkatërrimit të tyre gjatë krajatave që përjetuan ata. Kjo rrugë e dhunshme, bartë në vete, ndërkaq dhe qëndresën e vet, të njerëzve të cilët marshonin drejt shtetit amë, në kohë dhe hapësirë, ku gjejmë një tematikë prekëse, të dhimbshme e mjaft komplekse.

Gjatë gjithë këtij udhëtimi nëna e Artit zihet përbrenda si eshka, kujdeset me njerezit e saj për të birin dhe të tjerët, që në fakt është dashuria e paepur e nënës për ta shpëtuar të birin, që e përjeton luftën në moshë kaq të re. Por, ky nuk është i vetëm. Me kolonën udhëtonin edhe gra e fëmijë të tjerë, dhe për më tepër ky udhëtim të kujton legjenden e njohur të Sizifit, bartë gjithë kuptimin e dramës së madhe që ka mundur të shndërrohet në tragjedi. Udhëtimi jetë-pavdekësi

është një kuptim tjetër i kësaj proze të shkruar me një frymë, që do të tronditë thellë shpirtin e lexuesit, dhe njëkohësisht e bën të pavdekshëm udhëtimin e dhunshëm të mijëra shqiptarëve, me pretekst të spastrimit të Kosovës.

Qëndresa e njeriut nëpër këtë udhëtim makabër jepet në këtë prozë në formë ditari, ku shenohën edhe detajet më të imëta të tij, kurse pavdekësia paraqitet si nocion që autorja e ka shprehur me perpjekjet e nënës se Artit për të mbijetuar, bartë sekuenca të dhembshme, por alternativë tjetër nuk ka përveçse të qëndrojë dhe të kthehet përsëri në Kosovë. Dhe, kthimi ndodhë pas çlirimit, që për njerëzit e udhëtimit të tillë është një rilindje, që përfton si perdellimë me realizëm e psikologji të thellë. Të gjitha ngjarjet janë dhënë bindshëm, edhe pse është dashur, që më tepër të jepet ana

e përgjithshme, universale, duke u thelluar në përshkrimet tronditëse edhe të udhëtarëve të tjerë.

Sidoqoftë, tema e tillë që sjell kjo autore, është mjaft interesante dhe ndër prozat e para qe flet për eksodin e përdhunshëm gjatë luftës.

Ilir Prokshi

SUMMARY

After a period of twenty years of continuous occupation, in accordance with premediated Serbian state policies, the years 1998/1999 have marked the most violent methods for the annihilation of the Albanian population in Kosovo. The purpose was to evacuate Kosovo from its inhabitants, thus expelling the country's population

beyond the county's borders towards an unknown fate and without any life support.

At first, the evacuation was done through arrangements from local bus stops. Later, because this manner of operation was interrupted, the innocent population continued to be escorted beyond the country's borders simply by machine guns pointed at their backs, thus forcing them to walk on foot through convoys formed spontaneously by simple gatherings of people without any criteria. The walking convoys of people were forced to keep all the time within their column lines heading towards the Kosovo-Albania border, regardless of the furious seasonal rainfall on unprotected and newer ending walking line of people, some of which were barefooted. All along the way, the mistreatment did not stop, until finally, just before crossing the Albanian border, the

column was not allowed to go any further. It had to turn back for further abuse.

Along with other children, women and elders, my son Arti shared the same fate, and thus, under my guidance, he had to go through the challenges of war like everyone else. We were somehow always aware of these challenges. This is mainly as the result of general reading habits, memories and vivid evocation from our elders or previous generations, not to exclude the circulating media news at the time concerning the most terrible regional and international wars. For us Albanian nationals, this type of fortune we have experienced once too often in the past, which brings us to ask ourselves - why is history continuously repeating itself?

Apart from Arti, seventeen members of my immediate close family were also part of the

convoy, which was roughly 2500 people of all different ages. The 22-day drama was conveyed with many difficulties. The biggest difficulties, those coming from the human factor, were in the form of small and large groups of Serbian police and paramilitaries, whose presence most often came into a standpoint through various mistreatments for us who were part of the convoy.

The most sensitive age groups, children and old people, were those who mostly suffered because of the lack of food, and because of this they often fell ill. In such cases, the mothers' maximum dedication reached the deserved value. The faith in God, I presume, was what kept them going. Old people experienced dramatic moments. They often surrendered to fate, for they were not able to keep up with pace of the convoy. Often they were buried on site.

On this so-called road without a clear end, because of such difficult conditions, repeatedly you become a witness of the most inhumane behavior, which brought serious consequences amongst Albanians who were part of the convoy. On the other hand, you could also observe human gestures. These are often within the people you would least expect to behave in this way. What's more, there were also cases when a person from the side of the enemy, at the most critical moment, would save your life.

For a long while, the convoy was forcibly made to retreat into the village called Zabllaq – Municipality of Gurakoc. Then soon after, we had to leave here as the result of the unexpected heavy shelling coming from Serbian artillery, thus expelling us with ferocity from the village so we could head further towards the border with Albania.

At the village exit, the pace of events that followed were so fast and unpredictable. The people of the convoy had barely any strength left to face and deal with these events, especially bearing in mind the weakened moral and physical state they were in at the time. In addition to systematic subjecting to insults, beatings and robberies, now we are faced with a terrifying separation of the male gender from the convoy. At those critical moments, the emotional suffering was so unbearable that we thought this was something we would never be able to cope with. At such moments of wailing and grief, you feel completely lost and without any hope for salvation. Fortunately, the event ended without the most horrific consequences, which is not to say this was the fate of many other convoys who went through similar ordeals before and after.

From that moment on and until we managed to cross the border with Albania, a multitude of other events took place, which are presented with essential originality. These sufferings end and slowly turn into a dream from the past, with hope and prayer that it will never return again. The day of returning to liberated Kosovo arrives soon enough. The miracle happened on June 12, 1999…

DRITA SHALA - ÇUNAKU

KOLONA E UDHËS SË DJEGUR

COLUMN OF THE BURNT ROAD

Ura mbi lunin Ibër_1929

Ura mbi lumin Ibër_sot

Arti_2002

Arti_2002



Arti 2021



Autorja

DRITA SHALA - ÇUNAKU
KOLONA E UDHËS SË DJEGUR